



KOMUNA E ISTOGUT

PROGRAMI TREVJEÇAR I BANIMIT 2023 – 2026



PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	5
2.	QËLLIMI.....	5
3.	KORNIZA LIGJORE.....	6
4.	STRATEGJITË E HARTUARA NË NIVELIN QEVERTITAR.....	7
5.	KORNIZA INSTITUCIONALE DHE PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT.....	7
6.	PROFILI I KOMUNËS SË ISTOGUT.....	9
7.	GJENDJA FAKTIKE.....	13
8.	KËRKESA FAKTIKE PËR PËRKRAHJE PËR ÇËSHTJE TË BANIMIT.....	19
9.	ANALIZA E FAKTEVE.....	20
10.	ANALIZA EKONOMIKE.....	21
11.	ANALIZA SOCIALE.....	30
12.	KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE.....	31
13.	TRENDI I ZHVILLIMIT NJERËZOR.....	35
14.	GJENDJA SOCIALE.....	35
15.	PUNËSIMI.....	36
16.	PAPUNËSIA.....	37
17.	GJENDJA SOCIALE.....	37
18.	AMBIENTI BIZNESOR.....	38
19.	TË ARDHURAT.....	42
20.	KATEGORITË E SYNUARA.....	43
21.	KLASIFIKIMI I NEVOJAVE SIPAS URGJENCËS SË TRAJTIMIT TË TYRE.....	43
22.	VEPRIMET QË DO TË NDËRMERREN.....	44
23.	JUSTIFIKIMI I VEPRIMEVE DHE SHPJEGIMI I REZULTATEVE.....	46
24.	KOHËZGJATJA E REALIZIMIT TË PROJEKTIT.....	47
25.	KORNIZA E SHPENZIMEVE AFATSHKURTËR, AFATMEMSE, AFATGJATE.....	48
26.	TRENDI I SHPENZIMEVE KOMUNALE DHE PARASHIKIMET AFATMESME PËR PËRIUDHËN 2023-2025.....	49
27.	MUNDËSITË DHE KAPACITETET NJERËZORE DHE MATERIALE.....	49
28.	MËNYRA E FINANCIMIT TË PROGRAMEVE TRE VJEÇARE.....	49
29.	PËRPUTHJA E PROGRAMIT ME PLANET ZHVILLIMORE TË KOMUNËS.....	50
30.	INSTRUMENTET MBIKQYRËSE.....	50
31.	INSTRUMENTET E GARANTIMIT TË REALIZIMIT TË PROGRAMEVE.....	50

32.	PËRFSHIRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN E SIGURIMIT TË TRANSPARENCËS.....	51
33.	TRANSPARENCA NË HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE.....	52
34.	ÇËSHTJE TJERA.....	52
35.	PËRFUNDIMET	53

Shkurtesat

PTB – Programi Trevjeçar i Banimit

GP – Grupi Punues

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

PZHK – Plani Zhvillimor Komunal

RRK – Rikthimi i Ri integruar i Komuniteteve

MKK – Ministria për Komunitete dhe Kthim

KKR – Komisioni Komunal për Riatdhesim

UA – Udhëzim Administrativ

DFEZH – Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

MMPHI – Ministria për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë

DPHNB – Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit

MSH

PPP – Partneriteti Publiko Privat

HZ – Harta Zonale

DPUM – Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

OSHP – Organi Shqyrtues i Prokurimit

OE – Operator Ekonomik

AK – Autoritet Kontraktues

DI – Drejtoria e Inspektionit

1. HYRJE

Programi Trevjeçar i Banimit Social, i adresohet zgjidhjes së çështjes së banimit social në komunën e Istogut, ngase e drejta për banim është ndër të drejtat elementare të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut si dhe Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga aspekti social, banimi adekuat është një e drejtë themelore e njeriut, ndërsa nga aspekti i planifikimit hapësinor/urban banimi konsiderohet si shfrytëzuesi më i madh i hapësirës. Si çështje sociale dhe çështje të planifikimit strategjik të një vendi, adresimi i çështjes së banimit në mënyrë të duhur siguron zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm

Në këtë kontekst, qasja në banim është një disiplinë multi-sektoriale mjaftë komplekse që kërkon nga autoritetet qendrore dhe komunale përkushtim dhe vullnet politik për të adresuar me kompetencë këtë çështje.

Me miratimin e ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164, i është dhënë një kornizë më e avancuar autoriteteve vendimmarrësve lokale për të ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Kosovës.

Sigurimi i banimit është bazë për funksionalizimin e familjes, shoqërisë, por edhe të vetë shtetit, si për nga stabiliteti psikik-social ashtu edhe ai ekonomik. Andaj, me këtë program synojmë që të vendosim rend në adresimin e çështjeve të banimit në komunë, qoftë banim i përhershëm, i përkohshëm ose i formave të tjera të mbështetjes për kategoritë e popullatës që nuk kanë fuqi ekonomike për të paguar qira në tregun e lirë të banesave.

2. QËLLIMI

Qëllimi i hartimit të programit trevjeçar të banimit në komunën e Istogut është adresimi i çështjeve të banimit në territorin e komunës së Istogut bazuar në politikat qendrore të banimit, së pari duke:

Identifikuar pasqyrën reale të problemeve në komunën e Istogut, që kanë të bëjnë me çështjen e banimit;

Zhvilluar politika adekuate përfshirë specifikat lokale, veçoritë gjeografike, demografike dhe institucionale për zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike për të siguruar banim me çmime të tregut;

Krijuar kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit;

Gjetur mënyrat e financimit për realizimin e zbatimit të Programit Trevjeçar të Banimit.

Dokumenti është përgatitur në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Komunale Trevjeçare të Banimit bazuar në ligjin Nr. 03/L-164, për financimin e Programeve të Veçanta të Banimit .

Dokumenti është hartuar nga grupi punues komunal që ka për qëllim të bëjë përshkrimin e një rrjedhë kronologjike të banimit nga e kaluara, gjendjen ekzistuese dhe parashikimet e zhvillimit të banimit në vitet në vijim.


3. KORNIZA LIGJORE

- Ligji Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit;
- Ligji Nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi;
- Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale;
- Ligji nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
- Ligji nr.04/L -247 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
- Ligji nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-247;
- Ligji nr. 05/L – 031 për procedurën e përgjithshme administrative;
- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit në kuadër të Ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2010 për përmbajtjen e kontratës për banesën me qira jo profitabile;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2010 për përmbajtjen e bonusit të banimit;
- Udhëzimi Administrativ-nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ Nr.23/2010 për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit;
- Udhëzim administrativ- nr. 24/2010 për normat minimale të banimit për banesat nga programet e veçanta të banimit;
- Statuti i komunës;
- Plan i zhvillimor i komunës së Istogut 2019 – 2027;
- Harta zonale 2022 – 2030 (draft).

4. STRATEGJITË E HARTUARA NË NIVELIN QEVERTAR

- Strategjia kombëtare për ri integrimin e personave të riatdhesuar, plani i veprimit dhe rregullorja nr. 22/2020 për ri integrimin e personave të riatdhesuar;
- Strategjia kombëtare për ri integrim te qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë 2018-2022;
- Strategjia dhe plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare - 2022-2026.

5. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT



Diagrami i hierarkisë në proces të hartimit të Planit Trevjeçar të Banimit

Komisioni i hartimit të programit

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
01.	Ali Nimanaj	Nënkryetar i Komunës	Kryesues i G.P
02.	Merita Bytyçi	Drejtoreshë e Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale	Anëtare
03.	Agon Dreshaj	Drejtor i Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi	Anëtar
04	Dukagjin Hoxhaj	Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis	Anëtar
05	Jozef Frrokaj	Zyrtar nga Qendra Për Punë Sociale	Anëtar
06	Abedin Neziraj	Zyrtar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	Anëtar
07	Arta Fetahu	Zyrtare nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	Anëtare
08	Gazmend Sadriaj	Zyrtar Ligjor nga Drejtoria për Kadastër	Anëtar

- Vendimi i Kryetarit të komunës së Istogut, me nr. protokolli Nr.Br.01-607/022 i datës 17.08.2022 për përgatitjen e projektit të Programit të Veçantë për Banim në komunën e Istogut për periudhën 2022-2025;
- Sigurimi i te dhënave nga drejtoritë/zyrat relevante komunale;
- Identifikimi i grupeve të synuara;
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë (UA Nr.21/2010) për gjendjen faktike të çështjes së banimit;
- Struktura e buxhetit komunal në Istog,
- Përgatitja e dokumentit;
- Bërja publike e PTB-së - informimi;
- Procedurat e miratimit të dokumentit;
- Aprovimi nga Kuvendi i komunës.

6. PROFILI I KOMUNËS SË ISTOGUT

HISTORIKU

Informata të përgjithshme për Istogun

Të dhënat tregojnë se Istogu si vendbanim në vendin e sotëm, është formuar në shekullin e mesëm. Në territorin e komunës së Istogut janë gjetur gjurmë vendbanimesh që datojnë edhe nga parahistoria.

Gjatë kohës së sundimit të Turqisë, kazaja (komuna) e Istogut i ka takuar Sanxhakut të Pejës e pos tij edhe kazatë e Gjakovës, Beranes (Ivangradi) dhe Gucisë.

Rrethi i Istogut në kuptimin e sotëm administrativ është formuar më 1913, pas pushtimit të Kosovës nga ana e ushtrive serbo-malazeze. Kufijtë e sotëm të komunës së Istogut përafërsisht përputhen me ata të ish-rrethit të Istogut me qendër në Istog, pos që komuna e Zllakuqanit tash i takon komunës së Klinës, Radavci –komunës së Pejës, ndërsa Runiku - komunës së Skënderajt. Në atë kohë, ky rreth ishte i organizuar në gjashtë komuna: Istog, Gjurakoc, Rakosh, Zllakuqan, Vrellë dhe Radavc (këto dy të fundit më vonë janë bashkuar në një komunë me qendër në Vrellë).

Në vitin 1955 (kur rrethi i Istogut iu bashkëngjiti atij të Pejës) territori ka qenë i organizuar në 7 komuna, kurse pas riorganizimit ato u pakësuan në 2, në komunën e Istogut dhe atë të Gjurakocit.

Istogu si qendër e rrethit ka funksionuar prej vitit 1912 deri në vitin 1947. Më 1947 qendra u transferua në Gjurakoc. Më 1 janar të vitit 1960, u bë edhe një riorganizim i organeve lokale të pushtetit, kështu që në tërë territorin e Kosovës u suprimuan të gjitha rrethet. Pas suprimimit, u bashkuan komunat Istog e Gjurakoc, me qendër në Istog për të formuar njësinë e administrimit lokal ashtu si funksionon edhe sot.

Me 30 prill 1924, përmes dekretligjit, Istogu shpallet qytezë. Me shtimin e përmbajtjeve administrative, arsimore e kulturore, Istogu (dhjetor,1978) shpallet qytet dhe punohet plani urbanistik i tij. Gjurakoci gjithashtu është shpallur qytezë por nuk dihet data e shpalljes.

Istogu ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, e hapur në të gjitha anët, më përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar më male të larta më lartësi mbidetare përtej 2.000 metrave. Më një infrastrukturë të mirë rrugore, që i mundëson komunikim të mirë më trevat tjera të Kosovës.



Foto 1. Istogu sot.



Foto 2. Istogu i viteve 30-ta.

Ky territor, në aspektin gjeografik dhe etnik-kulturor njihet si Podgur. Si nocion, Podguri është një nën krahinë etnografike që zë pozitën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Kufizimi gjeografik i Podgurit fillon me burimin e lumit Drini i Bardhë, ngjitet në majën e Rusolisë, vazhdon me masivin e maleve të Moknës, ndërsa kufiri lindor e juglindor është lumi Gujavç. Takimi i lumit Gujavç, me lumin Istogu dhe me Drinin e Bardhë e përmbyll gjeografikisht trevën e Podgurit. Popullata autoktone e ka emërtuar “pod i gurit” shkëmbin i cili i detyron tri burimet e ujit Istogun, Vrellën dhe Drinin e Bardhë të shpërthejnë në të njëjtën lartësi mbidetare. Istogu gjendet në qendër të Podgurit.

Ka relief karakteristik me të gjitha format gjeomorfologjive, ka burime me potencë të ujit si Istogu e Vrella, si dhe nëpër pjesën dërmuese të territorit ka traversën Drini i Bardhë. Po ashtu ka sasi të mëdha të ujit nëntokësor, i cili e ka rrjedhën e vet nëntokësore paralele me rrjedhat sipërfaqësore. Falë lartësisë së ulët mbidetare, 350-450 metra mesatarja, lugina e lumenjve në mes Drinit e Istogut llogaritet ndër rajonet më të favorizuara të Ballkanit, në aspektin klimatik. Këtu depërtojnë, përmes luginës së Drinit të Bardhë, rrymat mesdhetare të cilat e favorizojnë zhvillimin e vegjetacionit bimor.

Pozita gjeografike, klima, pasuritë natyrore, kanë kushtëzuar që Istogu të jetë i banuar që nga lashtësia. Ai ishte pjesë integrale e hapësirës iliro-shqiptare. Në territorin e komunës së Istogut janë gjetur gjurmë vendbanimesh që datojnë edhe nga parahistoria. Istogu është i pasur po ashtu me vlera emblematike të trashëgimisë së kulturës materiale dhe shpirtërore.

Ekspedita hulumtuese e Institutit arkeologjik të Kosovës me karakter të përnjohjes, ka evidentuar 30 vend-gjetje arkeologjike me një shtrirje kohore që nis me neolitin e vonë, koha e bronzit, hekurit, periudha iliro-romake, paleokristiane shqiptare e deri të mesjeta. Në projektin e inventarizimit të trashëgimisë kulturore në trevën e komunës së Istogut, realizuar pas luftës së fundit, janë evidentuar shumë objekte arkitektonike autoktone si:

72 kulla, një sërë mullenjë më ujë si objekte të teknologjisë së bluarjes së drithit, xhami, mejtepe dhe kisha, një urë e gurit, arkitektonikë osmane dhe 9 vend-ndodhje arkeologjike.

Sipas burimeve historike thuhet se Istogu është shtrirë në pjesën e territorit në mes të Istogut të madh dhe Istogut të vogël, aty ku bashkohet lumi i Istogut me lumin e Qaushit. Sipas shënimeve ka ekzistuar një koloni romake e cila ka qenë e vendosur në lokacionin që i përket Istogut të sotëm. Po ashtu, Istogu përmendet si lokacion edhe ka fundi i shekullit XIV kur kjo pjesë e Dardanisë ishte nën pushtimin sllav.



Foto 3. Lagje e vjetër e Istogut



Foto 4. Lagje e re e Istogut

Gjatë kohës së sundimit turk, Istogu si vendbanim ka qenë i njohur me mullinjtë për bluarjen e drithit, dhe të punëtorive për përpunimin e leshit (zhgunit).

POPULLSIA

Tani nga regjistrimi i fundit i popullsisë, pas rezultateve përfundimtare në shumicën e fushave të cekura mund të kemi të dhëna më të sakta. Por, kjo nuk nënkupton që të dhënat ekzistuese janë tërësisht të pashfrytëzueshme.

Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të fundit të popullsisë, komuna e Istogut ka 39,289 banorë. Nga ky numër të gjinisë mashkullore janë evidentuar 19,962 kurse të gjinisë femërore janë evidentuar 19,327 banore.

Të dhënat mbi popullsinë dhe statistikën e punësimit në komunën e Istogut nga regjistrimi i fundit në prill të vitit 2011, duken kështu:

Nga komunitetet që jetojnë në komunën e Istogut (sipas të dhënave nga zyra për çështje të komuniteteve në kuadër të zyrës së kryeministrit):

- 90.01% Shqiptar
- 5.44% Egjiptian
- 0.11% Rom
- 3.33% Boshnjak
- 1.11% Serb

BARAZIA GJINORE

Barazia gjinore është një gur themeltar në procesin e zhvillimit demokratik të një kombi. Për të vendosur këtë gur atje ku duhet është e nevojshme të merren në konsideratë të gjitha pabarazitë gjinore që karakterizojnë sot familjen, komunitetin, tregun e punës dhe në përgjithësi shoqërinë.

Transformimi i thellë politik, social dhe ekonomik pas vitit '99, solli ndryshime të dukshme në strukturën e ekonomisë, nivelin e jetesës së popullatës, si dhe ekuilibrin gjinor në shoqërinë e Kosovës. Mirëpo përkundër këtyre ndryshimeve, kjo nuk ka ndikuar në masë të madhe në përmirësimin e gjendjes së pozitës së grave në shoqëri. Nga pikëpamja demografike, gratë në Kosovë përbëjnë gjysmën e popullsisë. Deri në fund të viteve të 80-ta dominonte familja patriarkale, ku 2-3 breza jetonin në një familje. Mirëpo pas viteve 90-ta nga emigrimi që u bë jashtë Kosove dhe migrimi i popullatës nga zonat rurale drejt zonave urbane, përshpejtuan shpërbërjen e familjes patriarkale.

Me gjithë përmirësimet në vitet e mëvonshme, papunësia dhe varfëria kërcënojnë një numër jo të vogël familjesh në Kosovë, por në mënyrë të veçantë papunësia dhe varfëria po ndikojnë negativisht në statusin social të grave.

Tradicionalisht gratë kanë barrën kryesore të mirëqenies në familje, megjithatë ato kanë më pak mundësi se burrat në përdorimin e burimeve dhe mjeteve që nevojiten për përmbushjen e përgjegjësisë të tyre. Niveli i lartë i papunësisë, niveli ulët arsimor, angazhimi i grave të pakualifikuara në punë, mungesa e mundësive kualifikuese, qasja e dobët dhe mungesa e lirisë së përdorimit të metodave të planifikimit familjar, pastaj fakti që shumë shpesh gratë janë objekt i dhunës, i keqtrajtimit dhe veprimeve arbitrare në familje, si dhe përfaqësimi i dobët në strukturat publike drejtuese dhe politike, po ndikojnë në thellimin e varfërisë në Kosovë, dhe në zgjatjen e saj.

7. GJENDJA FAKTIKE

POZITA GJEOGRAFIKE

Informata të përgjithshme

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit. Komuna, në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në veri-lindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jug-perëndim me komunën e Pejës.

Qendër komunale është qyteti Istog. Komuna ka 50 vendbanime prej të cilave 1 është qytet - Istogu, 1 vendbanim është qytezë - Gurrakoci dhe tjera vendbanime janë fshatra: Banja, Bajica, Llukavci i Begut, Belica, Bollopoja, Veriqi, Vrella, Orroberda, Dobrusha, Istogu i Poshtëm, Dragolevci, Dreja, Dubrava, Zhakova, Zallçi, Zabllaqi, Kaliqani, Kashica, Kovraga, Koshi, Kërrnina, Llugat, Lubova, Lubozhda, Dubova e Vogël, Mojtiri, Muzhevina, Veriqi i Ri, Osojani, Polana, Prekalla, Prigoda, Rakoshi, Syneja, Serbobrani Saradrani, Cërkolezi, Sudenica, Llukavci i Thatë, Suhogërlla, Shushica, Tomoci, Trubuhoci, Tuqepi, Uça, Carralluka, Cërrca dhe Shalinovica.

Organizimi administrativ territorial i Kosovës karakterizohet me ndarje kadastrale, si ndarjet më të vogla të nivelit organizativ në nivel komunal, të cilat në kohën kur është bërë ndarja kanë treguar vendbanime, ndërsa sot me rritjen e vendbanimeve, një ngastër kadastrale mund të përfshijë edhe dy vendbanime. Rrjedhimisht, sot Istogu ka 46 ndarje kadastrale, ndërsa numëron 50 vendbanime. Po ashtu, një njësi kadastrale në bashkësinë lokale të Osojanit është e ndarë por nuk përfaqëson asnjë vendbanim.

Informatat e fundit statistikore për komunën dhe qytetin janë të vitit 2011. Numri i banorëve, sot në komunë, vlerësohet të jetë 39,289. Numri i amvisërive 6,741, ndërsa mesatarja e anëtarëve në familje është 6. Dendësia e banimit në komunë është 86.5 b/km².

Nga 39,289 banorë, 19,327 janë femra ndërsa 19,962 janë meshkuj, do të thotë raporti gjinor është 49% /51%.

Tabela 1. Atlasi i regjistrimit të popullësisë 2011

Nr.	Vendbanimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Sipërfaqja e njësishë katastrale	Dendësia banimore
1	Banjë	653	707	1360		
2	Banjicë	286	266	552	3,205,663	172
3	Belicë	40	32	72	10,372,877.37	7
4	Bellopojë	88	88	176	4,451,433.23	40
5	Carrallukë	293	288	581	2,948,167.69	197
6	Cerkolez	178	168	346	17,638,619.87	20
7	Cerrcë	602	646	1248	14,725,615.06	85
8	Dobrushë	570	608	1178	12,763,214.39	92
9	Dragolec	204	216	420	4,067,920.99	103
10	Drejë	209	206	415	1,302,270.43	319
11	Dubovë e Vogël	128	130	258	2,476,012.92	104
12	Dubravë	989	394	1383	11,626,576.39	119
13	Gjurakoc	1135	1074	2209	10,746,703.89	206
14	Istog	2560	2555	5115	30,345,596.70	188
15	Istog i Poshtëm	295	302	597		
16	Kaliqan	421	414	835	22,088,635.15	38
17	Kashicë	256	237	493	2,536,061.85	194
18	Kërninë	261	277	538	6,889,577.94	78
19	Kosh	121	124	245	9,395,020.23	26
20	Kovragë	373	358	731	5,621,987.06	130
21	Lubovë	376	356	732	7,401,010.93	99
22	Lubozhdë	452	441	893	14,956,118.80	60
23	Llugë	289	300	589	2,325,403.72	253
24	Llukac i Begut	649	618	1267	4,782,697.99	265
25	Llukac i Thatë	84	76	160	5,393,220.72	30
26	Mojstir	151	130	281	12,673,204.28	22
27	Muzhevinë	310	316	626	3,444,628.82	182
28	Orobërdë	533	554	1087	8,893,049.10	122
29	Osojan	38	27	65	11,426,883.11	6
30	Polanë	6	9	15	7,954,748.76	2
31	Prekallë	158	185	343	4,072,600.43	84
32	Prigodë	302	269	571	2,561,446.98	223
33	Rakosh	430	442	872	4,955,962.62	176
34	Serbobran	170	151	321		
35	Sinajë	104	124	228	41,741,117.33	5
36	Staradran	784	779	1563	5,460,035.56	286
37	Studenicë	757	738	1495	17,260,739.24	87
38	Suhogërlë	456	439	895	7,560,103.91	118
39	Shalinovicë	47	58	105	5,238,850.51	20
40	Shushicë	765	768	1533	24,565,700.13	62
41	Tomoc	372	393	765	3,266,479.84	234
42	Trubuhoc	416	488	904	3,517,273.01	257
43	Tuçep	6	6	12	7,622,628.13	2
44	Uçë	401	385	786	18,699,567.17	42
45	Veriq	239	210	449	6,274,241.41	76
46	Veriq i Ri	16	13	29		
47	Vrellë	1333	1308	2641	23,773,916.77	111
48	Zabllaq	233	226	459	10,551,595.35	91
49	Zallq	249	253	502		
50	Zhakovë	174	175	349	10,493,709.45	33
	ISTOG	19962	19327	39289		

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës

Në raport me qendrat rajonale në Kosovë si dhe me qytetet e rëndësishme në shtetet fqinje, Istogu ka lidhje të mira rrugore. Rruga kryesore Mitrovicë-Pejë kalon nëpër territor të komunës ndërsa disa rrugë e lidhin komunën me Prishtinën dhe Klinën fqinje. Lidhje të mira ka edhe me Rozhajën (Mal i Zi) të cilat realizohen përmes rrugëve Istog-

Pejë-Rozhajë dhe Istog-Radavc-Rozhajë. Përmes rrugës Istog-Rakosh-Cërkolez, komuna lidhet me Zubin Potokun.

Istogu ka lidhje të mira edhe me rrjetin rrugor duke qenë 27 km larg stacionit hekurudhor të Pejës dhe afër 23km larg stacionit hekurudhor në Klinë. Lidhja rrugore e komunës me këto stacione është mjaftë e mirë, gjë që mundëson transportin e mallrave (në të kaluarën e ka shfrytëzuar stacionin në Pejë).

Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, kultivimit të kulturave bujqësore, perimeve, pemëve, si dhe zhvillimin e blegtorisë, shpezërisë, dhe bletarisë.

Administrimi territorial përmes bashkësive lokale luan rol pozitiv në ofrimin e shërbimeve administrative dhe shërbimeve tjera sociale si arsimi, shëndetësia etj. ndaj qytetarëve.

Plani Zhvillimor Komunal vazhdon ta zhvillojë administrimin territorial në komunën e Istogut, përmes qeverisjes lokale në administratën komunale. Bazuar në numrin e parashikuar të popullsisë në zonën urbane, propozohet që numri i bashkësive lokale të rritet në tri, ndërsa bashkësitë lokale në fshatra vazhdojnë të jenë të administruara në nëntë njësi. Komuna e Istogut përfshinë një sipërfaqe prej 453.84 km².

Tabela 2. Sipërfaqja e komunës së Istogut, e ndarë në njësi lokale

1. ISTOG	1 Istogu	5115	5995
	2 Istogu i Poshtëm	597	700
	3 Uugë	589	690
	4 Lubozhda	893	1047
	5 Muzhevinë	626	734
	6 Cerrca	1248	1463
		9068	10629
2. GURAKOC	1 Gurakoci	2209	2589
	2 Veriqi	449	526
	3 Kovraga	731	857
	4 Veriqi i Ri	29	34
	5 Savllaka (ish Sërbobrani)	321	376
	6 Llukavci i Thatë	160	188
	7 Tomoci	765	897
		4664	5467
3. VRELLË	1 Vrella	2641	3095
	2 Kalçani	835	979
	3 Prigoda	571	669
	4 Studenica	1795	1752
		5842	6495
4. BANJË	1 Baja	1360	1594
	2 Bajica	552	647
	3 Kashica	493	578
	4 Lubova	732	858
	5 Dubova e Vogël	258	302
	6 Orroberda	1087	1274
	7 Corolluka	581	681
		5063	5934
5. RAKOSH	1 Rakoshi	872	1022
	2 Belica	72	84
	3 Zhakova	349	409
	4 Kërnina	538	631
	5 Shushica	1533	1797
		3364	3943
6. DUBRAVË	1 Dubrava	1383	1621
	2 Bellopoja	176	206
	3 Dragolevci	420	492
	4 Mojstiri	283	329
	5 Syneja	226	267
		2488	2915
7. ZALLQ	1 Zallçi	502	588
	2 Dreja	415	486
	3 Zabllaqi	459	538
		1376	1612
8. OSOJAN	1 Osojani	65	76
	2 Koshi	245	287
	3 Polana	15	18
	4 Tuqepi	12	14
	5 Shalinovica	105	123
		442	518
9. DOBRUSHË	1 Dobrusha	1178	1381
	2 Llukavci i Begut	1267	1485
	3 Prekalla	343	402
	4 Saradrani	1563	1832
	5 Trubuhoci	904	1060
		5255	6160
10. CËRKOLEZ	1 Cërkolezi	346	406
	2 Syrigona (ish Suhogerrlla)	895	1049
	3 Uça	786	921
		2027	2376

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2019 – 2027

Tabela 3. Administrimi territorial i Komunës së Istogut

KOMUNA E ISTOGUT				
Nr. i popullsisë				39,289 b.
Zonat rurale				34,174 b.
Zonat urbane				5,115 b.
Nr. i Vendbanimeve				50
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999			6,000
	Nr. objekteve pas 1999			2,100
	Etazhiteti mesatar			P+1 27
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve		540
		Nj. banimi		55
	Pas 1999	Nr. objekteve		1,073
		Nj. banimi		1,073
	Etazhiteti mesatar			P+6
Statusi pronësor [banim kolektiv) para 1999			Privat [nj. banimi]	
			Shoqëror [nj. banimi]	
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]				90/10
Kryeje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]				80%
Nr. i objekteve të pabanuara				/
Nr. i objekteve me vlerë kulturore historike që shfrytëzohen për banim				
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]				
	Mbindërtimet			n/a
	Ndërtimet tjera			n/a
	Ndërtimet në pronë shoqërore			n/a
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit				220

Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit		n/a
Nr. i objekteve/nj. banimi të ndërtuara nga komuna qeveria dhe donatorët		334 objekte
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë		n/a
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshme për qira të ulëta të tregut		n/a
Nr. i objekteve/nj. banimi ne pronësi te komunës që mund të adaptohen		n/a
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	n/a
	Vendndodhja /emërtimi	n/a
	Nr. i familjeve	n/a
	Nr. i banorëve	n/a
Planet rregulluese	Katër plane rregulluese, Dy plane zhvillimore urbane, PZHK 2019-2027, HZ,2022-2030(Draft)	

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2019 – 2027, dhe Harta Zonale 2022 – 2030 (draft)

Tabela 4. Të dhënat mbi popullsinë në Komunën e Istogut

POPULLSIA		
1	Dendësia	115.5 b/km ²
2	Mosha 0-24 vjeç (kryesisht % e moshës së re)	62.4%
3	Familja mesatare	6 anëtarë
4	Nataliteti	Rreth 13% në vit
5	Arsimimi	tek të rriturit në %
		Meshkuj Femra
		97.54 91.47

6	Migrimi	18.7% e popullsisë jetojnë në botën e jashtme
7	Ekonomit familjare	7,540
8	Banesat	1,613 banim shumë banesorë
9	Situata ekonomike	Rreth 1,000 biznese të vogla dhe të mesme

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Komunën e Istogut

Shfrytëzimi i tokës për komunën e Istogut është bërë duke u bazuar në inçizimet satelitore të vitit 2007 duke përfshirë këto kategori:

- Sipërfaqe e tokës ndërtimore
- Sipërfaqe e tokës bujqësore
- Sipërfaqe e tokës pyjore
- Sipërfaqe tjetër e tokës pyjore/kullosa
- Sipërfaqe ujore

Gjithashtu në llogaritje janë marrë edhe kategoritë si: zonë e veçantë e mbrojtur, qendra e paraburgimit dhe trafo stacioni Peja 3.

Tabela 5. Të dhënat mbi shfrytëzimin e tokës në Komunën e Istogut.

SHFRYTËZIMI I TOKËS		
1	Sipërfaqe e tokës ndërtimore	3,357.16/ha
2	Sipërfaqja e planifikuar - tokë bujqësore	18,186.32 ha
3	Sipërfaqja e tokës pyjore	22,707.16 ha
4	Sipërfaqja e kullosave	1,118.53 ha
5	Zonë e veçantë e mbrojtur	107.7 ha
6	Qendra e paraburgimit Dubrava	49.02 ha
7	Trafo stacioni Peja 3	6.34 ha
Vërejtje: në këto sipërfaqe hyjnë edhe rrugët, lumenjtë, prrojet.		

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2019 – 2027

Tabela 6. Fondi Banesor Komunal

FONDI BANESOR		
1	Nr. i objekteve të banimit	1,759 njësi të banimit në qytetin e Istogut
2	Nr. i banesave në pronësi komunale (në kuadër të objekteve kolektive)	3/23-25 njësi banesore gjithsejtë 71 njësi banesore
3	Me partneritet publik privat	8 banesa
4	Qendra për banim social	3/23 njësi banesore
5	QPK (Qendra të përkohshme kolektive)	n/a

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2019 – 2027

Tabela 7. Mbulueshmëria me plane sipas PZHK-së, PZHU-së, HZ-së dhe vendbanimet joformale

MBULUESHMËRIA ME PLANE		
1	Sipërfaqja e përgjithshme e komunës e përfshirë në PZHK	309 km ²
2	Sipërfaqja e përgjithshme e komunës e përfshirë në PZHU	439.58 h
3	Mbulueshmëria me plane rregulluese, Harta zonale	439.58 h
4	Numri i vendbanimeve joformale në komunë	7.00

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2019 – 2027, dhe Harta Zonale 2022 – 2030 (draft) dhe Plani Zhvillimor Urban

8. KËRKESA FAKTIKE PËR PËRKRAHJE PËR ÇËSHTJE TË BANIMIT

Tabela 8. Kërkesat e parashtruara ndër vite

1.	Viti 2020	61
2.	Viti 2021	44
3.	Viti 2022 (deri në muajin gusht)	17

Burimi: Sistemi i protokolimit dhe arkivimit të kërkesave (INTRANET)

Në vitin 2022 janë parashtruar gjithësej 61 kërkesa, prej tyre 54 kanë qenë kërkesa për ndërtim të shtëpive ndërsa 7 kanë qenë për pagesë të qirasë. Në vitin 2021 kanë qenë gjithësej 44 kërkesa për përkrahje, ku 37 kërkesa prej tyre kanë qenë për ndërtim të shtëpive, ndërsa 7 kërkesa kanë qenë për pagesë të qirasë. Deri në gusht të vitit 2022 kemi pasur gjithësej 17 kërkesa për përkrahje të çështjeve të banimit, ku 8 kërkesa kanë qenë për ndërtim të shtëpive dhe 9 kërkesa për pagesë të qirasë.

9. ANALIZA E FAKTEVE

Punimet në sektorin e banimit nga Komunën e Istogut kanë filluar menjëherë pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë. Ndërtimi i infrastrukturës si dhe krijimi i kushteve më të mira për jetë janë investimet që janë bërë në kuadër të investimeve në ekonominë e komunës së Istogut. Investimi përfshin dy faza:

Faza I kishte për qëllim përmirësimin e kushteve të banimit dhe ekonomive familjare për familjet e mbijetuara nga lufta, ku faktor vendimtar kanë qenë donatorët e ndryshëm, kryesisht ndërkombëtar, që investimet e tyre kryesisht i kanë bërë në ngritjen e ekonomive familjare në sektorin e banimit.

Ndër organizatat që dhanë më së shumti kontribut gjatë fazës I, ishin UNDP, DRC, Mercy Corps, Caritas Switzerland, Caritas Austria, Kryqi i kuq Austriak, etj.

Faza II nënkupton periudhën e investimeve kapitale dhe krijimin e kushteve më të mira, duke përfshirë infrastrukturë më të zhvilluar si dhe zhvillim të ekonomisë së mirëfilltë për të gjithë qytetarët e komunës së Istogut pa dallim. Pas konstituimit të organeve vendore si ato lokale po ashtu edhe qendrore orientimi i mjeteve bëhet në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e komunës së Istogut. Kështu, nëse kategorizojmë investimet varësisht nga prejardhja e mjeteve buxhetore, përfshijmë tri kategori: investimet nga mjetet buxhetore, investimet nga donatorët, si dhe ato me pjesëmarrjen e qytetarëve.

Investimet nga donatorët janë më të shumta sipas vlerës dhe përbëjnë mbi 80% të investimeve, ndërsa nga programet e realizuara përfshihen kryesisht ato urgjente. Përfitues në ndërtimin e shtëpive nga donatorët në periudhën emergjente ishin 1,024 familje.

Në vitin 2006-2009, në komunën e Istogut është zbatuar programi për kthim të qëndrueshëm. Nga ky program në bashkëveprim me komunën janë zbatuar shumë projekte, shtëpi individuale. Në këtë fazë përfitues janë kryesisht pjesëtarë të komunitetit serb që kanë shprehur dëshirën për kthim, ndërsa në tërësi nga këto projekte kanë përfituar 150 familje në ndërtimin e shtëpive të banimit, mjete këto të donatorëve, MKK, si dhe komuna e Istogut.

Jo vetëm pjesëtarët e komunitetit shumicë apo edhe atij serb rezultojnë të kenë përfituar nga donacionet dhe mjetet buxhetore lokale dhe qendrore, por edhe pjesëtarë të tjerë të minoriteteve, siç është minoriteti rom, ashkali dhe egjiptian. Për këto komunitete janë ndërtuar rreth 20 objekte të banimit, si në qytet e po ashtu edhe në fshatrat e Istogut. Për të bërë më të qartë dhe më të lehtë kuptimin e fakteve të përshkruara deri më tani, ne kemi ndarë analizën e fakteve të paraqitur në dy pjesë: si analizë ekonomike dhe si analizë sociale.

Në kuadër të projektit të ndërtimit RRK (në bashkëpunim me IOM) gjatë fazës së fundit, në komunën e Istogut përgjatë viteve 2019 – 2022 janë ndërtuar 20 shtëpi për pjesëtarë të komunitetit serb të cilët kanë kërkuar rikthimin në vendin e tyre në komunën tonë.

10. ANALIZA EKONOMIKE

Istogu, zhvillimin e vetë e mbështet në resurset njerëzore dhe natyrore, në traditën e popullatës së kësaj ane dhe llogaritet si një vend i potencialit dhe traditës bujqësore, me agrikulturë, blegtori, peshkatari dhe pylltari të zhvilluar.

BUJQËSIA

Bujqësia si degë e rëndësishme e ekonomisë ka një rendësi të madhe për komunën e Istogut. Njëra prej detyrave primare të bujqësisë është prodhimi i ushqimit të mjaftueshëm dhe cilësor për mbarë popullsinë, si dhe sigurimi i lëndës së parë për industrinë përpunuese.

Me bujqësi merret rreth 65% e popullsisë së komunës së Istogut dhe prej saj ajo siguron ekzistencën e vet. Në bazë të kushteve agroekologjike që ka rajoni i Istogut, mund të arrihen rendimente të kënaqshme dhe cilësore, si të kulturave lavërtarie ashtu edhe prodhimeve blegtorale. Edhe pse ekzistojnë kushte të volitshme natyrore dhe ka potencial njerëzor dhe të kualifikuar, zhvillimi dhe prodhimi i produkteve vendore të natyrës ushqimore është i ulët, dhe si pasojë e kësaj, kemi furnizim të pa mjaftueshëm me artikuj ushqimor të nevojshëm për popullatën. Për këtë arsye shumica e këtyre artikujve, si dhe materiali riprodhues, kryesisht vijnë nga importi, e që janë prodhime ushqimore si: mielli, qumështi, frutat, perimet, vaji, mishi, farat, etj.

Tabela 9. Struktura e sipërfaqes bujqësore në komunën e Istogut

Nr.	Struktura e sipërfaqes bujqësore	ha
1.	Ara	10,085.21
2.	Vreshta	23.77
3.	Pemishte	715.8
4.	Livadhe dhe jonxhë	6,404.37

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2019 – 2027

Tabela 10. Sipërfaqja /ha dhe numri i aplikuesëve për subvencione 2022

Nr.	Sektori		Viti 2022	Sipërfaqja/ha	Nr. i aplikacioneve
1	Lavërtari	Grurë sipërfaqe		2.338,54	404
		Grurë kg			
		Grurë për farë		59.39	1
		Misër		1.749,6	456
		Thekër		14.25	6
		Elb		46.16	28
		Tërshërë		54.25	29
		Luledielli		2.05	1
2	Perime kulturë	Perime në fushë		115.58	86
		Perime në serra		1.17	4
		Fasule monokulturë		5.63	2
		Kunguj misri		10.13	8
		Vreshta		10.68	2
3	Pemëtari	Pemë		324.26	180
		Pemë të imta		4.81	7
		Material fidani		65.200	1
4	Blegtori	Lopë qumështore		4.299 krerë	449

		Qumësht litra		2,768,140.14	80
		Bletë		8,028 koshere	127
		Dele		7,701 krerë	76
		Dhi		1,341 krerë	16
		Viça për majmëri		316	21
		Rosa		11	3
5	Shpezëri	Pula		30.500	3
	Akuakulturë	Peshk		276,422.18 Kg	3
6	Bimë mjekësore dhe aromatike	Konvencionale		45.43	18
7	Bujqësi organike	Organike		109.38	5
8	Ara	Totali:		4.900 Ha	

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Istogut 2019 – 2027

Komuna e Istogut ka përparësi të mëdha për zhvillimin e bujqësisë duke filluar nga:
 Kushtet agroekologjike mjaftë të favorshme,
 Resurset natyrore, toka, pasuritë ujore (lumenjtë), etj.
 Fuqia punëtore, me përvojë dhe e kualifikuar,
 Shitja e produkteve në tregun e brendshëm si dhe mundësia për eksport.

Krahas përparësive ekzistojnë edhe vështirësitë në zhvillimin e bujqësisë. Një prej vështirësive që po ballafaqohet komuna e Istogut për zhvillimin e mirëfilltë të bujqësisë është dëmtimi i kanaleve për ujitje si dhe mungesa e riparimit të atyre ekzistuese. Në komunën e Istogut ekziston një rrjet i gjerë i kanaleve për ujitje të tokave bujqësore në gjatësi prej 85.50 km.

Në këtë mes duhet cekur se shumica e kanaleve për ujitje në komunën e Istogut janë kanale të hapura të ndërtuara qysh në vitet e 30- ta, përkatësisht vetëm 9 kilometra janë të betonuara. Kështu që, nga 3,990 hektarë të arave të planifikuara për ujitje nga sistemi i kanaleve të ujitjes, që furnizohen me ujë nga burimet dhe lumenjtë që përshkojnë komunën e Istogut, si burimi i Istogut, Drini i Bardhe dhe burimi i Vrellës, ujiten vetëm 1,240 hektarë.

Nga kjo sipërfaqe, 150 hektarë ujiten nga grumbullimi i rrjedhave të ujërave nëntokësore.

Për shkak se kanalet e ujitjes janë të tipit të hapur e të pa betonuar, dhe nuk pastrohen me rregull, gjatë reshjeve të mëdha gjatë stinëve të vitit, uji i tyre vërshon sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore dhe shkaktojnë dëme dhe erozione duke shkatërruar sipërfaqe të mëdha të tokave. Vetëm gjatë vitit të kaluar nga reshjet dhe daljet e ujërave nga shtretërit janë vërshuar 170 hektarë tokë e punueshme.

Po ashtu mangësi e rrjetit të ujitjes në komunë është edhe mungesa e pendëve përkatësisht digave për ujitjen e tokave, si në Bajicë, në Lluga të Saradaranit si dhe Gurrakoc, aty ku bashkohet Jazi i Gogës me Shushicën.

Një problem të veçantë për bujqësinë e komunës së Istogut paraqesin dëmtimet e kanaleve, ana e majtë dhe e djathtë e burimit të Istogut, prej nga ujitej shumica e sipërfaqes së tokës bujqësore e komunës së Istogut. Këto kanale janë të tipit të mbyllur me tubacione në gjatësinë deri në 25 km, mirëpo ato janë dëmtuar nga hapjet e dhunshme, përkatësisht hapja e vrimave përgjatë rrjetit të kanaleve për nevojat e banorëve nga shtrihet ky rrjet.

Kurse në dhjetë vjetet e fundit uji i këtyre kanaleve nuk arrin të shkojë në vendet e caktuara, në arat e komunës së Istogut, për shkak se shfrytëzohet nga prodhuesit e fermave të peshqve, të cilët janë të detyruar që ujin e përdorur pas trajtimit, përkatësisht filtrimit, ta kthejnë në kanal që të përdoret për ujitje. Mirëpo ata nuk e bëjnë gjë, kështu që uji i kontaminuar nga hurdhat e peshqve derdhet në përroska apo në rrjetin e kanalizimeve, e nga aty në lumin e Istogut.



Foto 5. Korrrja e Grurit



Foto 6. Ujitja e tokave bujqësore

Vështirësitë me të cilat ballafaqohet bujqësia e Istogut janë:

- Sipërfaqja e tokës mjaft e kufizuar, me tendencë të zvogëlimit nga ndërtimet e pa kontrolluara në tokat bujqësore,
- Sipërfaqja në pronësi të fermerit është e copëtuar në disa ngastra të vogla, çka e pa mundëson shfrytëzimin racional të tokës dhe mekanizmit bujqësor,
- Mungesa e kapitalit qarkullues te fermerët,
- Marketingu i prodhimeve bujqësore nuk është i organizuar,
- Mungon tregu i ndërmjetëm-grumbullimi i produkteve, deponimi, ruajtja në frigorifer të mëdhenj dhe përpunimi i tyre, etj.
- Çmimi i lartë i repromaterialit, etj.
- Shfrytëzim i pakontrolluar i resurseve natyrore,
- Konkurrenca globale e tregut,
- Qasje e kufizuar në resurset financiare,
- Mungesë e ndihmës teknike,
- Pasiguria në investimet afatgjata.

Mundësitë janë evidente:

- Zhvillimi i tregtisë jashtë Kosovës,
- Mundësi e mirë për shtimin e prodhimeve vendore,
- Investime në shtimin e vlerës së prodhimeve vendore,
- Menaxhim më i mirë i resurseve ujore,
- Menaxhim më i mirë i viseve malore dhe pyjore,
- Zhvillimi i turizmit rural dhe malor.

Prodhimtaria perimore

Komuna e Istogut, sidomos zona e Fushës, përkatësisht rajoni i njohur si Lugu i Drinit, njihet si rajon i kultivimit të perimeve duke ju falënderuar kushteve agroekologjike si dhe traditës së fituar të bujqve në kultivimin e tyre. Kjo i jep komunës së Istogut një karakteristikë të jashtëzakonshme agrare. Këto sipërfaqe mundësojnë shfrytëzimin intensiv për arsye të mundësisë për ujtitje.

Sipërfaqet e bujqësisë së komunës së Istogut i përbëjnë arat dhe kopshtet me sipërfaqe prej 12 059 ha, zakonisht të mbjella me kultura të cilat paraprijnë: gruri, misri, elbi, jongja, perime, etj. Gjithashtu të volitshme janë edhe kushtet për kultivimin e mollës,

kumbullës, dardhës, qershisë, vishnjës, ftoit dhe pjeshkës.

Përbërja e tokës dhe mundësia për t'i ujitur ato, mundësojnë produktivitet të madh të perimeve të ndryshme, e sidomos: patates, specit, shalqirit, pjeprit, qepës, domates dhe lakrës.



Foto 7. Zhvillimi i kopshtarisë.



Foto 8. Zhvillimi i pemëtarisë.

Zhvillimi i pemëtarisë

Zhvillimi i pemëtarisë ka një rëndësi të madhe në aspektin ekonomik dhe social nga se frutat e pemëve qoftë në gjendje të freskët apo të përpunuara janë një komponentë e rëndësishme për ushqimin e popullatës. Nutricistët botëror rekomandojnë që të shpenzohen rreth 115 kg fruta të pemëve në vit për kokë të banorit, kurse tek ne në Kosovë sipas disa shënimeve statistikore harxhohen diku rreth 45 kg frute të pemëve në vit. Nga këtu shihet edhe kërkesa për kultivimin e pemëve, faroreve (molla, dardha, ftoni, etj), bërthamorëve (kumbulla, vishnja, pjeshka, etj), arroreve (arra, lajthia, etj), frutave të imta (dredhëza, mjedra, manaferra) të cilat janë shumë të kërkuara si në tregun e brendshëm ashtu edhe në tregun ndërkombëtar

Me rëndësi duhet të jenë edhe masat stimuluese apo subvencionet shtetërore:

- Stimulimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve,
- Sigurimi i fidanëve cilësore, varietete me potencial të lartë prodhues dhe të qëndrueshëm ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve,
- Të organizohen trajnime për fermerët për ngritjen dhe menaxhimin e pemishteve,
- Të ngriten fidanishte bashkëkohore për prodhimin e fidanëve,
- Sigurimi i kredive me kushte të volitshme,
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes (përfshirja e të gjitha sipërfaqeve të mundshme të tokës me ujitje,
- Ngritja e depove bashkëkohore për ruajtjen e pemëve dhe përpunimit të tyre etj.



Foto 9. Dardha

Foto10. Molla

Foto 11. Kumbulla

Rekomandimet për të ardhmen e bujqësisë ne komunën e Istogut

- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtimet e egra,
- Zgjerimi i qytetit të racionalizohet me ndërtime të larta, banime kolektive,
- Të bëhet komasacioni apo grupimi i tokave, sepse parcelat e imtësuar dhe të shkapërderdhura të një prone janë një nga faktorët imitues për një prodhimtari bujqësore të organizuar, për aplikimin e masave bashkëkohore agroteknike për shfrytëzimin racional të makinave, aplikimin e qarkullimit bimor, për shfrytëzimin e sistemit për ujitje, etj.
- Hapja e sipërfaqeve të tokës që janë të mbuluara me shkurre, shpyllëzimi i sipërfaqeve me pyje të ulëta (rrafshinat dhe bregoret e mundshme), me qëllim të shtimit të sipërfaqeve të punueshme,
- Riparimi i sistemit ekzistues të ujitjes, zgjerimi i rrjetit të tij, ngritja e pendëve nga betoni për gjatë lumit të cilat përdoren për ujitje dhe parandalimi i përmytjeve, Shfrytëzimi i hapësirave për akumulime të vogla të ujit të cilat do të kontribuojnë në radhë të parë në mikroklimën e rajoneve përkatëse, zhvillimin e peshkatarisë, shfrytëzimin e ujit për ujitje, ngritjen e hidrocentraleve të vogla energjetike si dhe për rekreacion,
- Organizimi i fermerëve në bazë të veprimtarisë së tyre (blegtor, pemëtar, kultivues të perimeve etj.) në kooperativa bujqësore, shoqata të fermerëve, sindikatën e bujqve etj.
- Marketingu i prodhimeve bujqësore, grumbullimi, ruajtja, përpunimi i prodhimeve bujqësore dhe shitja e tyre (ekzistimi i tregut të ndërmjetëm)

- Ngritja profesionale e fermerëve (organizimi i kurseve, trajnimeve për lëmit përkatëse të bujqësisë.
- Aplikimi i teknologjive të reja në prodhimtarinë bujqësore,
- Përdorimi i farërave dhe fidanëve cilësore me potencial të lartë të prodhimit,
- Shfrytëzimi i kullosave ekzistuese në viset kodrinore malore dhe aplikimi i prodhimtarisë ekologjike në blegtori në pjesët kodrinore malore,
- Ngritja e fidanishteve dhe pemishteve me pemë të ndryshme,
- Ngritja e serrave për kultivimin e perimeve përkatësisht eliminimi i karakterit sezonal në prodhimtarinë perimore, dhe kultivimin e luleve.
- Përmirësimi i gjendjes së mekanizimit bujqësor.
- Ruajtja e pyjeve nga prerjet ilegale dhe ripyllëzimi i tyre,
- Zhvillimi i gjuetisë për rekreacion,
- Ruajtja e bimëve mjekuese si dhe shqyrtimi i mundësive për kultivimin e tyre,
- Rregullimi i infrastrukturës nëpër zona rurale do të kontribuonte zhvillimit të bujqësisë, pengimit të migrimit të popullsisë fshat-qytet etj.

Agrikultura (blegtoria, bimët mjekuese)

Blegtoria, si veprimtari ekonomike në këtë zonë, kryesisht zhvillohet më afër vendbanimeve dhe si veprimtari sezonale (gjatë verës) në kullosa dhe livadhe. Livadhet dhe kullosat si resurs dhe potencial për blegtori, shtrihen kryesisht në këtë zonë. Mënyra se si funksionon sot kjo veprimtari nuk është e kënaqshme, dhe nuk ka një organizim të mirë. Për shfrytëzimin sa më të mirë të potencialeve të agrikulturës, janë të nevojshme aftësi dhe njohuri shtesë për prodhim dhe marketing, si dhe rritja e njësive bujqësore me madhësi mesatare.



Foto 12. Tufë delesh në bjeshkë



Foto 13. Panair i gjedheve të racës

Masat që duhet ndërmarr për përparimin e blegtorisë:

- Përmirësimin e racave të kafshëve,
- Prodhimi dhe përpunimi i ushqimit të kafshëve, përdorimi i mekanizmit bashkëkohor për përgatitjen e ushqimit voluminoz dhe atij të koncentruar si: makineri për përgatitjen e sillazhes, makinat për zhveshjen e misrit, rrotoballer për konservimin e ushqimit, aparatura për përgatitjen e ushqimit të koncentruar,
- Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve blegtorale (pika grumbulluese të qumështit),
- Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër fshatra (stacionet për përparimin e blegtorisë dhe shërbimet veterinare),
- Mënyra e sigurimit të mjeteve (financimit) për zhvillimin e blegtorisë.

Apikultura

Zhvillimi i kësaj veprimtarie është ngushtë i lidhur me bujqësinë e sidomos me kultivimin e pemëve të cilat sigurojnë kushte të mira dhe stimulojnë bletarinë. Ndikim tjetër pozitiv në zhvillimin e kësaj veprimtarie kanë edhe lulet dhe bimët tjera si erëzat, sidomos ato që rriten në zonat tjera, në bjeshkë dhe rrëzë. Prodhimet nga bletaria, mjaltë dhe dylli kanë përdorim të gjerë edhe nga kompanitë farmaceutike dhe kozmetike si përbërës të medicinës dhe kozmetikës. Edhe në apikulturë, një organizim më i mirë mund të ndikojë në ngritjen si të kualitetit ashtu edhe të prodhimtarisë së mjaltës dhe prodhimeve tjera nga kjo kulturë. Shoqata e bletarëve duhet të synojë që produktet e mjaltit të kenë një etiketë kualiteti të mbrojtur që i shquan ato në Kosovë dhe jashtë saj.

Akuakultura (kultivimi i peshkut)

Burimet e ujit dhe kushtet tjera klimatike mundësojnë kultivimin e peshkut. Akuakultura është industri ushqimore e cila në botë po rritet shumë shpejt. Kjo veprimtari e bën Istogun të dalluar, jo vetëm këtë zonë por edhe komunën me rrethinë.

Akuakultura i referohet rritjes, kultivimit dhe prodhimit të gjitha llojeve të bimëve dhe shtazëve në ambientet ujore. Sikurse agrikultura, edhe akuakultura mund të zhvillohet në ambiente natyrore të krijuara nga njeriu.



Foto 14. Hurdhë e peshqve



Foto 15. Kultivimi i peshkut

Në Istog është i zhvilluar kultivimi i peshkut të ujërave të ëmbla.

Sasia e ujit dhe sipërfaqja e tokës në dispozicion, përcaktojnë tipin e pajisjeve për kultivim dhe numrin e peshqve që mund të kultivohen. Ujërat nëntokësor nga burimet dhe pusët, janë burimet më të mira të ujit për hurdha të peshqve, e që në këtë zonë janë të mjaftueshme. Gjithashtu edhe burimet tjera si ujërat sipërfaqësor, ujërat e lëvizshëm, etj. mund të përdoren për rritjen e peshkut, por natyrisht se të gjitha burimet duhet të jenë të pastra nga sëmundjet e peshqve, parazitët, peshqit bezdisës dhe grabitqarë, balta, pesticidet, klori dhe kemikalet tjera të cilat janë të dëmshme për shëndetin e peshqve.

Furnizimi i mirë me ujë me sasi të mjaftueshme dhe cilësor janë elementet thelbësore për kultivimin e peshqve në ferma.

Kurse vendet ideale për vendosjen e fermave janë pjesët më të larta të kësaj zone, ku toka është në nivel më të lartë nga sipërfaqet e vërshuara dhe furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pastër është i detyrueshëm.

11. ANALIZA SOCIALE

Raste me asistencë sociale: numri i familjeve shfrytëzuese të asistencës sociale për muajin korrik 2022 është 371 (e dhënë e marrë nga raporti mujor financiar “ndihma sociale”). Ndërsa, kërkesat faktike për përkrahje janë në rritje çdo ditë e më tepër. Në proces të shqyrtimit janë 5 kërkesa.

Kategori të dala nga lufta: prej vitit 2004 janë ndarë 24 banesa, ndërsa janë ndërtuar 5 shtëpi. Më status të pa zgjidhur të banimit përkundër që plotësojnë kushtet ligjore janë 6 familje;

Të kthyerit: Në vitin 2019 në bazë të kërkesave, dy familjeve u janë ndërtuar shtëpitë, projekt i financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Në vitin 2020, janë katër familje që u janë ndërtuar shtëpitë nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Ndërsa në vitin 2021, vetëm një kërkesë është aprovuar nga MKK-ja, dhe është në procedurë, ndërsa një kërkesë për ndërtim është refuzuar.

Të riatdhesuarit: Sa i përket kërkesave për rindërtim/renovim të shtëpive nga personat e riatdhesuar, gjatë periudhës raportuese kemi vetëm një kërkesë e cila është parashtruar për renovim, dhe nuk është kërkesë e kompletuar me dokumentacionin e kërkuar. Për këtë arsye është në pritje të plotësimit të dokumentacionit përkatës dhe pastaj do të shqyrtohet në komisionin komunal për riatdhesim (KKR).

Duhet cekur se nga buxheti i komunës nga viti 2012 e deri në vitin 2016 janë ndërtuar gjithsejtë 36 shtëpi. Nga viti 2019, për shkak të gjendjes me pandeminë COVID 19, nuk ka pasur zbatim të projekteve të tilla të ndërtimit nga ana e komunës së Istogut. Projektet e tilla parashihen që të vazhdojnë në vitet në vijim.

Të punësuar nga buxheti shtetëror: Në përgjithësi në komunën e Istogut janë 941 persona të punësuar në sektorin publik dhe rreth 2,000 të punësuar në atë privat, shumica prej tyre në qytetin e Istogut.

12. KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE

Popullsia

Në komunën e Istogut jetojnë rreth 39.289 banorë (bazuar në raportin e fundit të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 nga ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës). Në vitin 2003, sipas vlerësimeve dendësia në komunën e Istogut ishte rreth 87 banor /km², që është më e ulët se mesatarja e Kosovës për rreth 48 banorë/km².

Vendbanimet

Rrjetin e vendbanimeve në komunën e Istogut e përbëjnë qendra komunale Istogu, qendrat lokale, fshatrat, lagjet dhe grupet e shtëpive. Vlen të theksohet se nga pikëpamja hapësinore numri më i madh i vendbanimeve është përqendruar në viset fushore, rrëzë maleve e kodrave. Tipi i vendbanimeve është kryesisht vendbanimet e tipit të grumbulluar kryesisht fushore, por edhe kodrinore - malore dhe tipit të ndarë në lagje.

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit. Në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe me Serbinë, në veri-lindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës ndërsa në jug-

perëndim me komunën e Pejës. Istogu është vendbanimi i vetëm në komunë që ka statusin e qytetit dhe është qendër komunale. Përveç Istogut, komuna ka edhe 49 vendbanime tjera.

Dendësia mesatare e banimit në komunën e Istogut është 87 b/km². Territori i komunës shtrihet në lartësi mbidetare prej 400m deri 2155m në Bjeshkët e Nemuna. Ndërtimi i qendrës së qytetit dhe gjegjësisht drejtimet nga qendra që shpien në drejtim të Vrellës, Dubrava dhe drejtimi i Gurakocit, paraqesin boshtet përgjatë të cilave qyteti zgjerohet.

Pas krijimit të komunës së Istogut, qyteti i Istogut fitoi rolin e qendrës komunale, gjë që ndikoi në përqendrimin e funksioneve publike, administrative dhe ekonomike të rëndësishme për komunën dhe si rezultat u ndikua edhe fizionomia e Istogut si vendbanim. Në pjesën verilindore, në dalje të qytetit në drejtim të Dubravës, shtrihet zona industriale e cila ka një pozitë të mirë me një infrastrukturë të përshtatshme dhe qasje të mirë për hyrje dhe dalje në rrugët e qytetit.

Sipas PZHK-së, banimi është zhvillimi përgjatë tri drejtimeve kryesore rrugore dhe i definon konturat e jashtme të qytetit. Lagjet e banimit pothuajse në tërësi përbëhen prej banimit individual, ndërsa shumë pjesë të lagjeve janë të urbanizuara me plane rregulluese, mirëpo mungojnë plani detale urbane. Dendësia e banimit është 37.15 banor/ha, që është një dendësi relativisht e ulët duke pasqyruar se kemi të bëjmë me zonë urbane.

Banimi – Fondi Banesor

Në qytetin e Istogut dominon banimi i ulët, i cili në pjesën më të madhe përbëhet prej shtëpive individuale. Si shkas i banimit të ulët individual qyteti pasqyrohet me një dendësi të ulët të banimit prej 37.15 banorë/ha.

Nga 1,759 njësi të banimit në qytetin e Istogut, 280 apo 16% përbëhet nga banimi shumë banesorë, ndërsa edhe vetë fondi banesor është i shpërndarë në 40 seksione të cilat janë të ndërtuara në qendrën e ngushtë të qytetit si dhe përgjatë tri rrugëve kryesore që çojnë në drejtim të Gurakocit, Dubravës dhe në drejtim të Vrellës.

Periodha e ndërtimit të ndërtesave shumë banesore përfshin vitet '50 deri në vitet '90. Në shumicën e këtyre ndërtesave etazhiteti është P+4, kurse numri i banesave në kat sillet prej 2 deri në 4. Një pjesë e këtyre ndërtesave, sidomos ato më të vjetrat, kanë nevojë për intervenime në izolime, instalime, sistemin e largimit të ujërave atmosferike dhe elemente të fasadës.

Furnizimi me ujë në këto ndërtesa bëhet përmes ujësjellësit i cili ujësjellës ka nevojë vazhdimisht për zgjerim dhe riparime. Sistemi i ngrohjes qendrore nuk ekziston, ndërsa rreth 85% të familjeve për ngrohje shfrytëzojnë lëndën e drurit, rrymës si dhe atë të thëngjillit.

Pjesa më e madhe e shtëpive në qytetin e Istogut janë ndërtuar pas viteve '40, shtëpitë e ndërtuara gjatë periudhës së viteve '50 -'70 kanë përfshirë hapësirën përgjatë tri ndërtimeve kryesore rrugore duke i dhënë konturat që qyteti ka sot. Gjatë viteve '80-'90, ndërtimi i shtëpive ka plotësuar dhe zgjeruar kufijtë e qytetit përgjatë këtyre tri boshteve të zhvillimit.

Shumica e shtëpive janë të ndërtuara me etazhitet P+1 dhe P+2. duke llogaritur qendrën e qytetit me etazhitet P+4, P+5 dhe P+6. Shtëpitë që gjenden pranë rrugëve kryesore dhe më të frekuentuara të qytetit në rrugën Istog-Gurakoc, Istog-Dubravë dhe Istog-Vrellë kanë përdhese aktive ku dominojnë përmbajtjet tregtare, hoteliere dhe shërbyese.

Vlen të theksohet se furnizimi i lagjeve të banimit individual me infrastrukturë dhe shërbime ka nevojë për plotësime, megjithatë: 95% e shtëpive furnizohen me ujë nga ujësjellësi, ndërsa një pjesë e vogël e shtëpive furnizohen me ujë nga pusët, pjesa dërmuese e shtëpive kanë kyçe në rrjetin e kanalizimit të qytetit. Derdhja e ujërave të zeza zbrazet në lum.

Migrimi

Problem i njëjtë si në gjithë Kosovën qëndron edhe me komunën e Istogut, ku kemi emigrime dhe migrime të shumta, por asnjëherë nuk mund të japim shifrat e sakta se sa është numri i qytetarëve tanë që jetojnë punojnë dhe veprojnë jashtë territorit të komunës, sidomos atyre që jetojnë jashtë Kosovës.

Duke iu referuar raportit të rregullt vjetor të vlerësimit të popullsisë të publikuar nga ASK "Vlerësim - Popullsia e Kosovës 2021", numri i imigrimit kombëtar në komunën e Istogut është 162, ndërsa numri i emigrimit kombëtar nga komuna e Istogut është 137, që nënkupton se bilanci i migrimit kombëtar për komunën tonë është 25 (do të thotë kemi më shumë persona që janë kthyer/kanë hyrë në komunën tonë se sa që janë larguar).

Ndërsa në aspektin e migrimit ndërkombëtar, numri i imigrimeve është 103, ndërsa emigrimi është 406, që nënkupton se bilanci i migrimit ndërkombëtar është 303 (do të thotë që numri i personave që largohen nga komuna e Istogut në vendet e treta është më i lartë se i atyre të cilët riatdhesohen).

Shtimi natyror

Burime spitalore dhe burime tjera tregojnë se lindjet e periudhës 1999 deri 2022 tregojnë se numri i lindjeve në Kosovë është në rënie të vazhdueshme. Kjo rënie e lindshmërisë është si pasojë e rënies së vazhdueshme ekonomike dhe rritjes së varfërisë dhe pasigurisë në prosperitet dhe zhvillim ekonomik.¹

Edhe pse po thuajse të gjithë treguesit e shtimit të popullsisë kanë shënuar rënie gjatë viteve të fundit, popullata e Kosovës ende mbetet njëra ndër popullatat me shtim më të lartë në rajon, por edhe më gjerë. Ky është rezultat i zvogëlimit të ngadalshëm të shkallës së natalitetit dhe i zvogëlimit rapid të shkallës së mortalitetit. Shkalla e shtimit natyror është rreth 9%² në vit.

Jetëgjatësia

Është e njohur teoria se popullsia e varfër nuk jeton gjatë, kjo nuk mund të përjashtojë as banorët e komunës së Istogut. Statistikat tregojnë se popullsia kosovare jeton mesatarisht diku rreth 69 vite, diku afërsisht jetëgjatësia e popullsisë është e njëjtë edhe në Istog me atë të jetëgjatësisë në Kosovë.

Niveli i zhvillimit nuk mund të matet vetëm në bazë të të ardhurave, por duhet të merren parasysh edhe disa tregues të zhvillimit si: jetëgjatësia, arsimimi-shkalla e arsimimit të të rriturve, regjistrim në shkolla, të ardhurat për kapital etj.

- Jetëgjatësia, është një prej treguesve të rëndësishëm, kjo ka të bëjë me jetën e njerëzve, sa dhe si i përdorin burimet financiare në të mirë të përmirësimit të kushteve shëndetësore, ushqimit dhe standardit të jetës, nga këto të dhëna llogaritet treguesi i jetëgjatësisë.
- Zhdukja e analfabetizmit dhe niveli i shkollimit, të shprehura me përqindjen e popullsisë që nuk di shkrim lexim dhe me mesataren e viteve të shkollimit për ata që mësojnë në shkollë, na ndihmon në llogaritjen e koeficientit të shkollimit, apo treguesit të arsimimit.
- Prodhimi i brendshëm bruto, pasqyron të ardhurat mesatare për kapital, të llogaritura për fuqi blerëse, kjo na mundëson llogaritjen e treguesve të të ardhurave.

¹ Plani Zhvillimor Komunal

² ASK – “Vlerësim” – Popullsia e Kosovës 2021

13. TRENDI I ZHVILLIMIT NJERËZOR

Tabela 11. Trendi i Zhvillimit njerëzor në Komunën e Istogut krahasur me kryqytetin dhe në nivel vendi

Komuna	Prishtina	Istogu	Kosova
Jetëgjatësia prej lindjes	71	70.99	69
Shkalla e arsimimit të të rriturve (15+)	96	92.76	94
Shkalla e kombinuar e regjistrimit në shkolla (%)	91	85.42	88
Të ardhurat për kokë të banorit në Euro	1,586	944.60	1,053
Treguesi i jetëgjatësisë	0.77	0.76	0.73
Treguesi i arsimimit	0.94	0.88	0.92
Treguesi i të ardhurave	0.46	0.620	0.39
Treguesi i zhvillimit njerëzor	0.72	0.790	0.68

Burimi: Drejtoria Komunale e Arsimit – DKA, Istog

14. GJENDJA SOCIALE

Përqindja e arsimimit të njerëzve prej moshës 15 vjeçare e lartë - Istog

Tabela 12. Shkalla e arsimit në komunën e Istogut

Komuna e Istogut		
Nr.	Shkalla e arsimit në %	Nr. i përgjithshëm
1	Pa arsimim	0.51
2	Më pak se fillor (1-3) vite	2.54
3	Më pak se fillor (4-7) vite	15.79
4	Shkollë fillore	28.52
5	Më pak se shkollë të mesme (9-10)	7.47
6	Shkollë të mesme (11-12)	33.45
7	Shkollë të lartë	10.53
8	Universitet e më lartë	1.70
Gjithsej		100

Burimi: Drejtoria Komunale e Arsimit – DKA, Istog

Shkalla e arsimimit, shkalla e regjistrimit dhe mesatarja e viteve të shkollimit sipas gjinisë:

Tabela 13. Treguesit e edukimit të ndara sipas shkallës së nivelit të arsimimit dhe sipas gjinisë

	Shkalla e regjistrimit %									
	Shkalla e arsimimit		Fillor		Mesëm				Mesatarja e viteve të shkollimit	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Istog	97.72	88.78	95.24	93.24	74.36	62.79	88.62	81.90	10.18	7.80
Rural	97.03	90.97	95.61	95.94	75.24	66.13	88.71	85.69	10.00	7.94
Urban	97.54	91.74	94.03	95.98	83.38	78.39	90.54	89.70	10.88	8.99

Burimi: Drejtoria Komunale e Arsimit – DKA, Istog

Treguesi i zhvillimit njerëzor është një kombinim i treguesit të jetëgjatësisë, treguesit të arsimimit dhe treguesit të të ardhurave. Kjo llogaritje për herë të parë është aplikuar në Kosovë nga UNDP, në vitin 2004, ku ka dalë se Kosova ka treguesin e zhvillimit njerëzor në koeficientin prej 0.68, që janë marrë parasysh treguesi i jetëgjatësisë prej 0.73, treguesi i arsimimit prej 0.92 dhe treguesi i të ardhurave prej 0.39. Nga këta koeficient ka rezultuar se Kosova renditet në mesataren e vendeve me zhvillim mestar njerëzor.

15. PUNËSIMI

Zhvillimi i pabarabartë në aspektin ekonomik ndërthurë çështjen e papunësisë, shkallës së ultë të të ardhurave personale dhe mos investimet nëpër sektorë.

Shkalla e punësimit në komunën e Istogut është mjaft e ulët duke marrë për bazë numrin e popullsisë aktive për punë. Nga kjo del si rrjedhojë që ka shkallë të lartë të papunësisë.

Mirëpo nisur nga të ardhurat për kokë banori, në krahasim me komunat tjera të Kosovës, Istogu bën pjesë në grupin e pesë komunave më të zhvilluara të Kosovës.

Në sektorin publik ka të punësuar 930 punëtorë, në sektorin privat rreth 3,000 punëtorë, kurse prej fillimit të vitit 2022 e deri me tani të evidentuar në zyrën për punësim janë gjithsej 120 të lajmëruar, prej tyre 62 femra dhe 58 meshkuj³.

16. PAPUNËSIA

Tregu i të papunëve në Kosovë është shumë i lartë, ka shifra që tregojnë se 35% e popullsisë së aftë për punë nuk punon dhe nuk realizon asnjë të ardhur për veten dhe familjen e tij/saj.

Të papunësuar në komunën e Istogut të cilët janë gjithsej të lajmëruar në entin për punësim nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021 janë 110 raste aktive dhe 172 raste pasive, ndërsa nga janari i vitit 2022 deri më datën 08.09.2022 janë 135 raste aktive dhe 2 raste pasive.

17. GJENDJA SOCIALE

Tabela 14. Numri i të kualifikuarve të cilët janë të regjistruar si punëkërkues në Zyrën Komunale të Punësimit (01.01.2021 – 31.12.2021)

Nr.	Kualifikimi	Nr. i përgjithshëm	Femra	Meshkuj
1	Të pa kualifikuar	19	10	9
2	Gjysmë të kualifikuar	126	47	79
3	Shkollë e mesme profesionale	34	14	20
4	Shkollë të mesme gjimnaz	22	6	16
5	Bachelor	34	26	8
6	Master	3	2	1
7	PhD	0	0	0
8	Shkolla e lartë	1	0	1
Total		239	105	134

Burimi: Zyra Komunale e Punësimit, Istog

³ Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit 01.01.2022 – 08.09.2022.

Tabela 15. Numri i familjeve përfituese të asistencës Sociale ndër vite

Numri i familjeve përfituese të asistencës sociale		
Periudha	Familje	Anëtarë
2017	488	2054
2018	453	1980
2019	423	1801
2020	471	1920
2021	441	1723
2022	374	1570

Burimi: Qendra për Punë Sociale, Istog

18. AMBIENTI BIZNESOR

Resurset Turistike në shfrytëzim

Komuna e Istogut në vitin 1985 kishte 1,183 shtretër nga 6,217 sa kishte krejt Kosova, duke pasur kështu numrin më të madh të shtretërve në tërë Kosovën. Ndërsa numri i turistëve po këtë vit ishte 13,800, pjesa dërmuese e të cilëve ishin nga Kosova dhe viset tjera të ish Jugosllavisë.

Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, turizmi në tërë Kosovën në përgjithësi ka qenë duke u rritur me një ritëm të ndjeshëm, duke dhënë shenja që është një sektor me mjaft potencial për vendin. Në periudhën 2017-19, ardhjet e vizitorëve të huaj të regjistruar në të gjitha pikat kufitare të Kosovës kishin shënuar rritje për 10.7 %.

Mirëpo edhe përkundër këtyre treguesve pozitiv në atë kohë, sot turizmi në komunën e Istogut ka shkallë të ulët të zhvillimit krahas potencialeve që ka. Zhvillimi i turizmit në vitet e fundit i atribuohet kryesisht iniciativave sipërmarrëse të sektorit privat. Ndonëse ky është një tregues i mirë, turizmi, megjithatë, është një sektor që gjithashtu ka nevojë për intervenime, politika dhe veprime publike dhe, mbi të gjitha, një orientim të qartë strategjik.

Komuna e Istogut si dhe të gjitha komunat tjera të Kosovës nuk kanë një kornize standarde statistikore për matjen e ndikimit të turizmit në ekonomi dhe si rrjedhojë të dhënat zyrtare në këtë drejtim mungojnë. Produkti turistik që sot e ofron komuna e Istogut mbështetet kryesisht në turizmin malor dhe ekskursionet ditore në qytetin e Istogut.

Disa nga atraksionet e turizmit malor janë:

Ndër atraksionet pothuajse më të frekuentuara në Istog është pika vrojtuese (View Point), në qytetin e Istogut, më saktë mbi burimin e Istogut, ku edhe ka frekuentim të madh të qytetarëve nga të gjitha anët e Kosovës. Shtegu i cili qon tek pika vrojtuese ka gjatësi 986 m dhe lartësi mbi detare 758.49m dhe kjo kësaj pike vrojtuese i ofron një pamje mahnitëse të gjithë Podgurit.

Në fotografinë e dytë shihet burimi i ujit në Istog, ndërsa burim të tillë të ujit ka edhe në fshatin Vrellë.



(Burimi i fotove: Klubi Alpin "Podguri" – Istog)

Pastaj është shtegu i ecjes Istog – Pejë, ofertë e re turistike me sinjalizimet informuese. Ndryshe i quajtur shtegu tematik ndërkufitar me një gjatësi prej 100 km.

Mundësi e turizmit dimëror është shtegu "Via Dinarika" që fillon nga "Sejnova" deri të "Mokna" (41km) – Bjeshkët e Nemuna pjesa veri-perëndimore, me lartësi mbidetare prej 1,800m. Vend i vetëm ku mund të shihen bjeshkët e tërë Kosovës.

Paragliding në "Shoshan" vendosja e stacionit meteorologjik dhe dylbisë për ofrimin e pamjeve magjepsëse të rrafshit të Dukagjinit dhe përcjelljen e fluturimeve me Paragliding në bjeshkët e Istogut, dhe pika e paragliding në "Shymek" e vetmja pikë e paragllajdingut në Kosovë dhe konsiderohet si terreni më i përshtatshëm në tërë Kosovën për këtë lloj sporti.



(Burimi i fotove: Klubi Alpin "Podguri" – Istog)

Shpella më tërheqëse Via Ferrata, njihen si shpellat më të famshme binjake në Ballkan. Via Ferrata, shpellat binjake gjenden në bjeshkët e Istogut në vendin e quajtur bjeshka e Bajshës në lartësi 1,560 m/lmd , rreth 17 km larg qytetit të Istogut pranë rrugës (Istog – Mokën). Shpellat gjenden në pjesën veriperëndimore të vargmaleve të alpeve shqiptare (Bjeshkëve të Nemuna).



(Burimi i fotove: Klubi Alpin "Podguri" – Istog)

Bjeshka e Moknes apo siç e quajnë ndryshe "bukuroshja e Ballkanit" është një atraksion turistik mjaft i frekuentuar.




Foto: Liqeni i Moknës (Burimi i fotos: Klubi Alpin "Podguri" – Istog)

RESURSET TJERA TURISTIKE TË KOMUNËS

Komuna e Istogut ka resurse të vlefshme turistike të cilat sot nuk shfrytëzohen. Ajo ka trashëgimi natyrore, dhe biodiversitet të pasur, sidomos në viset e saj malore, si dhe trashëgimi kulturore me shtrirje hapësinore në tërë vendbanimet e saj.

Ndër këto resurse mund të veçohet burimi i ujit termal në Banjë. Resurs më potencial për zhvillimin e turizmit shëndetësor është burimi i ujërave termal në Banjë me karakteristika terapeutike. Uji i Banjës ka cilësi shëruese të sëmundjeve reumatike dhe të sëmundjeve tjera të ndryshme. Banja gjendet në lartësinë mbidetare prej 540 metra, në tarracën bigrene dhe nga të çarat e tokës burojnë disa gurra të nxehta, të vakëta dhe të ftohta minerale.

Për nga cilësia e tyre, hyjnë në radhën e ujërave tokësore-alkale, karbo-të tharta dhe me përmbajtje të vogël të sulfurit. Në bazë të mbeturinave të banjës së vjetër dhe të gypave të dheut, është konstatuar se ujërat e Banjës janë shfrytëzuar që nga romakët, pastaj nga sunduesit dhe aristokracia mesjetare e më vonë edhe nga turqit.

Mulliri për bluarjen e misrit në fshatin Vrellë, daton që nga viti 1922 dhe ende vazhdon të jetë funksional.



Mulli i vjetër në Vrellë



Brendësia e Mullirit në Vrellë

Muzeu komunal ku janë të ekspozuara gjetjet arkeologjike të evidentuara në disa lokalitete në komunën e Istogut si; tuma ilire të shekullit VIII-V p.e.s. Vendndodhja e tyre është në anën e majtë të rrugës rajonale Istog-Vrellë, 100m larg rrugës.

Kompleksi Trofta – është ndër vendet më të frekuentuara në Istog. Zhvillohet kultivimi i peshkut të ujërave të ëmbla, gjë që e mundëson sasia e bollshme e ujërave. Kjo veprimtari e bën Istogun të dalluar, jo vetëm në këtë zonë por edhe më gjerë.

Të qethat e deleve është një rit tradicional i cili organizohet çdo vit në bjeshkët e Istogut

në muajin Gusht. Kjo ngjarje tubon një numër të madh të qethtarëve vullnetarë, blegtorëve të shumtë, bashkatdhetarëve dhe qytetarëve që shkojnë për të parë nga afër ritin e qethjes së deleve si dhe për të shijuar bukuritë e bjeshkëve të Istogut .

Përveç vullnetarëve që kryejnë ritin e qethjes, një rit ky i vjetër dhe tashmë tradicional i blegtorëve të kësaj ane, pjesëmarrësve të këtij manifestimi u shërbehet ushqim dhe produkte tradicionale të bjeshkës.

Komuna e Istogut ka gjithsejtë 14 monumente kulturore nën mbrojtje, ndërsa janë evidentuar rreth 140 monumente apo zona tjera të trashëgimisë që mund të kenë vlera kulturore.

Pjesë e çmueshme e thesarit të trashëgimisë është edhe trashëgimia e lëvizshme dhe shpirtërore: veshja tradicionale, folklori, traditat dhe zakonet, arti popullor.

Resurset ekonomike dhe burimet njerëzore të Istogut janë shumë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe prosperitet ekonomik në shumë lëmenj, sidomos në bujqësi dhe minerale. Në komunën e Istogut veprojnë rreth 1,000 biznese.

Nga bizneset e regjistruara, shumica prej tyre kanë 1-3 punëtor, pastaj ato të mesme të cilat kanë nga 10-100 punëtor, numri i tyre është i vogël.

Vlen të theksohet se Istogu është i pasur me pasuri natyrore, ka pozitë të mirë për zhvillimin e bujqësisë, tokë pjellore ku gravitojnë gjashtë lumenjtë të cilët mund të shfrytëzohen për ujitjen e kulturave bujqësore. Në sferën industriale, është fabrika e pijeve Sinalco në Vrellë, Trofta në Istog, etj.

19. TË ARDHURAT

Sipas disa llogaritjeve të përafërta dhe empirike, të ardhurat për kokë banori në komunën e Istogut janë rreth 270€ - 320€ në muaj. Duhet cekur se Istogu ka një pozicion të favorshëm për zhvillimin e turizmit, blegtorisë dhe agro-turizmit , si dhe pjesa më e madhe e tokës ka mundësi të ujitet falë lumenjve të shumtë që gjenden në territorin e Istogut, megjithatë duhet punuar dhe ndikuar që zhvillimi i sektorit privat, agrobiznesit dhe zhvillimit të bujqësisë t'i kushtohet vëmendje dhe prioritet në politikat zhvillimore të pesëvjeçarit të ardhshëm.

20. KATEGORITË E SYNUARA

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike;
- Familjet në përkujdesje të fëmijëve jetim.
- Nënata vetushqyese.
- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politikë;
- Të kthyerit dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian;
- Të riatdhesuarit;
- Të punësuarit me të ardhura minimale me banim nën normat e banimit.
- Femrat që përjetojnë dhunë në familje (raste specifike);
- Familjet që jetojnë me përkujdesje të fëmijëve me probleme të përhershme shëndetësore që jetojnë në banesa nën norma të banimit;
- Personat me shkallë të invaliditetit të përcaktuar sipas nenit 9, të UA-së 21/2010.

Kategorizimi dhe specifikimi do të rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Programe të suksesshme konsiderohen kombinimi i përfituesve nga të gjitha kategoritë duke pasur parasysh edhe përzierjen e kategorive sa i përket moshës - të rinj dhe të moshuar.

21. KLASIFIKIMI I NEVOJAVE SIPAS URGJENCËS SË TRAJTIMIT TË TYRE

Përmes PTB-së komuna synon që të ofron banim të qëndrueshëm për personat dhe familjet që nuk kanë fuqi ekonomike të marrin me qira banesë me çmim të tregut. Me këtë nuk pretendohet që brenda afatit prej tri vjetësh t'i plotësojë të gjitha kërkesat por të veprohet hap pas hapi në mënyrë që me kapacitetet e veta modeste financiare dhe mbështetje eventuale nga niveli qendror të zgjidhë sa më shumë çështje të banimit.

Duke u bazuar në ligjin në fuqi si dhe në udhëzimet administrative, komisioni komunal, ka bërë identifikimin e kërkesave të paraqitura për banim dhe duke u bazuar në të, ka dalë me faktin se si kërkesa urgjente për zgjidhje të çështjes së banimit me qira jo

profitabile janë rreth 120 familje. Mirëpo, për këtë duhet edhe një rishikim dhe konsultim me vendimmarrësit për ndarjen e kësaj të drejte.

22. VEPRIMET QË DO TË NDËRMERREN

Nga mbledhjet e zhvilluara me komisionin komunal për hartimin e planit trevjeçar të banimit , **komisioni ka arritur në përfundim që do të ndërmerren këto veprime:**

1. PËRCAKTIMI I PARCELAVE PËR NDËRTIM, PRONË KOMUNALE

a. Veprimet:

- i. Vendimi për ndarjen e parcelës për ndërtim.

2. NDËRTIMI I OBJEKTIT BANESOR PËR DHËNIE ME QIRA JO PROFITABILE

a. Veprimet:

- i. Planifikimi Buxhetor Vjetor për ndërtimin e Objekteve të Banimit Social;
- ii. Marrja e Vendimit për ndërtimin e objektit (leja ndërtimore sipas PZHK-së dhe hartës zonale);
- iii. Hartimi i (kushteve ndërtimore), kushtet tekniko - urbanistike dhe detyra projektuese (Sipas PZHK-së dhe hartës zonale);
- iv. Shpallja e tenderit për hartimin e projektit të ndërtimit;
- v. Përzgjedhja e projektit për zbatim;
- vi. Nënshkrimi i kontratës me AK dhe OE;
- vii. Shpallja e tenderit për ndërtim, si dhe përzgjedhja e OE për zbatim të projektit dhe nënshkrimi i kontratës me AK dhe OE.

3. RIVLERËSIMI I GJENDJES EKONOMIKE TË FAMILJEVE NË PËRPUTHJE ME UA, NR. 18/2010 TË LIGJIT NR.03/L-164 PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË BANIMIT

a. Veprimet:

- i. Shpallja publike e Programit Trevjeçar të Banimit;
- ii. Formimi i komisionit për vlerësim;
- iii. Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve me qëllim të vazhdimit ose ndërprerjes së kontratës;
- iv. Përpilimi i listës përfituese;
- v. Largimi i familjeve që nuk i plotësojnë kriteret;

- vi. Përzgjedhja e familjeve të reja përfituese;
- vii. Nënshkrimi i kontratave dhe evidentimi në platformën elektronike “Data Baza e Banimit Social.

4. NË PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT

MARRJA MË QIRA ME BONUS E BANESAVE - SHITËPIVE PRIVATE DO TË BËHET SIPAS LIGJIT NR 03 L-164 NENI 15.

a. Veprimet:

- i. Caktimi i vlerës së bonusit të banimit për vitin aktual;
- ii. Formimi i Komisionit për identifikimin e banesave;
- iii. Kontakti me pronarët e banesave – shtëpive;
- iv. Hartimi i listës së banesave-shtëpive të mundshme për dhënie me qira;
- v. Hartimi i marrëveshjes me pronarët për shfrytëzimin e banesave me qira me bonus.

5. ADMINISTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE NË BASHKËPRONËSI

a. Veprimet:

- i. Zgjedhja e administratorit;
- ii. Zgjedhja e këshillave të banorëve;
- iii. Hartimi i projektit të menaxhimit;
- iv. Nënshkrimi i kontratës për administrim.

Tabela 16: Programet e banimit sipas kërkesave

			Programet /nën programet					Gjithsej
			Pr.1.1/ Përcaktimi i parcelave për ndërtim pronë komunale.	Pr.1.2 Ndërtimi i objektit me qira joprof. banesa	Pr.1.3 Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve	Pr.2.1 Marrja më qira me bonus e banesave-shtëpive private.	Pr.2.2 Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi	
1	Familjet me asistencë sociale	120	/	5	71	5	/	81

2	Kategoritë e dala nga lufta	65	/	25	/	10	/	35
3	Të kthyerit	17 Familje	/	/	/	/	/	/
4	Të riatdhesuarit	6 Shtëpi banimi	/	/	/	/	/	/
5	Të moshuarit	n/a	/	2	/	/	/	2
6	Të rinjtë	n/a	/	/	/	/	/	
7	Të punësuarit nga buxheti shtetëror	12 Kërkesa	/	3	/	/	/	3
8	Minoritetet	46 Kërkesa	/	/	/	/	/	/
Gjithsej:				35	71	10	/	121

23. JUSTIFIKIMI I VEPRIMEVE DHE SHPJEGIMI I REZULTATEVE

Duke u nisur nga kapacitetet dhe nevojat e mëdha për banim në komunën e Istogut, është punuar në gjetjen dhe identifikimin e hapësirave pronësore, pronë e komunës së Istogut, si dhe mundësia e dhënies për ndërtim të objekteve të banimit kolektiv për kategoritë me nevoja për strehim, si dhe kategorive të tjera shoqërore. Komuna e Istogut e ka një përvojë dhe shembull të mirë për ndërtimin e objektit banesor këtu në Istog, do të thotë në këtë rast komuna ka ofruar parcelën komplet me infrastrukturë, ndërsa donatori ndërtimin e objektit P+3, dhe në këtë objekt janë ndarë 20 njësi banesore. Vlera e këtij ndërtimi ka kushtuar 480,000.00 €. Investimi është bërë nga donatorët e jashtëm dhe komuna e Istogut.

Gjithashtu, mendojmë se gjatë periudhës 3 vjeçare komuna e Istogut t'i kushtojë rëndësi të veçantë realizimit të planit trevjeçar të banimit, ku mendojmë të bëjmë ndërtimin e 1 objekti tjetër banimi, përmes thithjes së donacioneve nga ana e Qeverisë, donatorëve, si dhe komuna e Istogut. Kostoja financiare e ndërtimit të këtij objekti do jetë rreth 500,000.00€, ndërsa komunës së Istogut i mbetet të ndajë mjete financiare në vlerë prej 150,000.00 € gjatë tri viteve.

Krahas dhënies së përparësisë të ndërtimit të objektit banesor që ka për qëllim zgjidhjen e strehimit për familjet që u mungon strehimi, komuna e Istogut ka vlerësuar që nevojë imediate është edhe mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e objekteve banesore, pasi që lidhur me këtë ekziston edhe Ligji nr. 04/1-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi.

Mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi është rregulluar me ligj, megjithatë është propozuar që komuna e Istogut të ndajë një buxhet vjetor për raste urgjente, dhe vlera e këtij buxheti të jetë 5,000.00 €.

Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve në përputhje me Ligjin nr. 03-L-164, si dhe udhëzimin administrativ UA nr. 18/2010, është po ashtu obligim ligjor që të menaxhohet sa më mirë shfrytëzimi i banesave, si dhe përmes rivlerësimit të sigurohen njësi banesore ku mund të vendosen familje të reja që i plotësojnë kriteret për strehim. Kjo nuk ka kosto financiare pasi që rivlerësimi bëhet nga zyrtarët e punësuar në komunën e Istogut.

Marrja me qira me bonus e banesave - shtëpive private, është një mundësi e mirë për ta shfrytëzuar për strehimin e familjeve që nuk kanë mundësi të paguajnë në tërësi qiranë, megjithatë komuna e Istogut nuk ka ndarë mjete që do mund të shfrytëzohen për bonus banimi, andaj i propozohet komunës së Istogut që me shqyrtimin e buxhetit të parasheh një shumë të mjeteve që do shfrytëzohen për këtë objektiv, si dhe t'i bëhet kërkesë MMPH që të ndaj një fond për këtë qëllim.

24. KOHËZGJATJA E REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Objektivi i parë do duhej të kryhet brenda afatit 3 mujor, pasi që kemi të bëjmë vetëm me veprim administrativ dhe e njëjta nuk bart kosto financiare.

Objektivi i dytë është ndërtimi i objektit banesor për dhënie me qira jo prifitabile. Kostoja arrin vlerën prej 500,000.00 €, dhe synohet që mjetet të sigurohen nga ministritë, donatorët, si dhe participimi i komunës me 150,000.00 € për tri vite.

Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi parasheh formën e menaxhimit si dhe zgjedhjen e një administratori i cili do jetë edhe person zyrtar që do jetë në kontakt me institucionin përgjegjës. Ky objektiv bart në vete një kosto minimale prej 5,000.00€, për raste urgjente.

Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve bëhet gjatë tre mujorit të parë të vitit nga institucioni përgjegjës dhe nuk bart kosto financiare.

Marrja me qira me bonus e banesave - shtëpive është një sfidë për ne, pasi që është një praktikë e re dhe konsiderojmë që do ketë kërkesa të shumta për përfitimin e bonusit.

Për këtë qëllim, komuna e Istogut do të ndajë 15,000.00€, gjatë 3 viteve të ardhshme.

25. KORNIZA E SHPENZIMEVE AFATSHKURTËR, AFATMEMSE, AFATGJATE

Tabela 17. Planifikimi i Buxhetit Komunale për 3 vite

Përshkrimi	2022 (buxheti aktual)	2023 (plani)	2024 (vlerësimet)	2025
1. TË HYRAT TOTALE KOMUNALE				
1.1 Të hyrat vetanake	1,145,615.00	1,244,588.00	1,295,934.00	1,351,480.00
1.2 Grantet qeveritare	10,466,384.00	11,808,883.00	12,681,958.00	13,120,064.00
1.3 Financim i jashtëm	11,009,500.00	12,752,500.00	1,916,452.00	160,000.00
2. SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE				
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	11,611,999.00	13,051,471.00	13,932,892.00	14,471,544.00
Pagat dhe mëditjet	6,511,000.00	6,852,429.00	7,242,559.00	7,507,364.00
Mallrat dhe shërbimet	1,593,959.00	1,656,580.00	1,608,538.00	1,855,724.00
Shpenzimet komunale	202,000.00	200,000.00	200,000.00	200,00.00
Subvencionet dhe transferet	310,000.00	319,000.00	314,000.00	309,750.00
Shpenzimet kapitale	2,995,040.00	4,023,462.00	4,567,795.00	4,598,706.00

Burimi: korniza afatmesme buxhetore-2023-2025 – Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Komuna Istog

26. TRENDI I SHPENZIMEVE KOMUNALE DHE PARASHIKIMET AFATMESME PËR PËRIUDHËN 2023-2025

Sipas rekomandimeve të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar edhe përmes qarkores buxhetore komunale 2022/1, komunat kanë fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2022, duke përfshirë kategorinë “paga dhe mëditi”.

Në bazë të udhëzimeve të dhëna në qarkoren buxhetore 2022/1, komuna e Istogut i paraqet parashikimet në vijim të shpenzimeve brenda kufijve të caktuar nga Ministria e Financave:

27. MUNDËSITË DHE KAPACITETET NJERËZORE DHE MATERIALE

Mundësitë, gjegjësisht kapacitetet materiale dhe njerëzore janë ndër sfidat kryesore në realizueshmërinë e shumë objektivave të parapara në PTB. Fakti që edhe pas tre vjetësh të miratimit të ligjit ende nuk janë themeluar, zyra, njësia apo sektori i banimit tregon për mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe financiare për zbatim të ligjit. Do të duhej të ndërmerren hapa konkretë që në strukturën komunale të gjendet vend për themelimin e një njësie të banimit duke bërë sistemimin nga kuadri ekzistues komunal.

Për më tepër sektori i krijuar duhet të llogaritet në menaxhimin më efikas të fondit të banimit duke bërë përpjekje për arkëtimin e rregullt të qirasë jo profitabile në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e rregullt e fondit komunal banesor.

28. MËNYRA E FINANCIMIT TË PROGRAMEVE TRE VJEÇARE

Tabela 18. Planifikimi i financimit të projektit për banim social, bazuar në buxhetin komunal dhe donatorët

Emri i Projektit	Periudha kohore	Etazhiteti	Kostoja e investimit në €	Burimi financiar	Vërejtje
Ndërtimi i banesave për strehim	2023-2026	P+4 deri P+6	500.000.00	Ministria Komuna Donatorët	Gjatë 3 viteve
Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi	2023-2026	/	10.000.00	Komuna	Gjatë 3 viteve
Marrja me Qira me bonus i banesave-shtëpive	2023-2026	/	65.000.00	MMPHI Komuna	Gjatë 3 viteve

29. PËRPUTHJA E PROGRAMIT ME PLANET ZHVILLIMORE TË KOMUNËS

Programi trevjeçar i banimit është hartuar në përputhje me ligjet ekzistues të Republikës së Kosovës. Objektivat e programit janë punuar në atë mënyrë që të jenë në përputhje me planet rregulluese urbane, plani zhvillimor komunal 2019 – 2027 dhe harta zonale 2022 – 2030 (draft).

Me rëndësi për programin është realizimi për 3 vitet e ardhshme, ndërtimi i një objekti me rreth 25 deri 35 njësi banesore, menaxhimi dhe mirëmbajtja e banesave, si dhe mundësia e aplikimit sa më efikas të bonusit të banimit.

30. INSTRUMENTET MBIQYRËSE

Themelimi i sektorit të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara i mundëson fillimisht komunës që të ketë mbikëqyrje të drejtpërdrejt në zbatimin e PTB.

Në këtë aspekt, edhe raportimi 6 mujor në Asamblenë komunale mbi të arriturat dhe pengesat në zbatimin e programit mund të konsiderohet si mjet efikas mbikëqyrës. Mirëpo, edhe vetë ligji e parasheh që MMPH të bënë mbikëqyrjen e zbatimit të tij përmes inspektorëve urbanistik.

31. INSTRUMENTET E GARANTIMIT TË REALIZIMIT TË PROGRAMEVE

Monitorimi i procesit të zbatimit të programit, vlerësimi i treguesve të suksesit për afatin e paraparë të veprimit si dhe bërja transparente e këtij vlerësimi e garanton realizimin më të efektshëm të programit,

Monitorimi është një mjet i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimësisë së zbatimit, duke i adresuar dhe përshtatur ndryshimet dhe pengesat në proces, e që përfshinë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të programit në krahasim me planin e veprimit;
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore;
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat);

- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në planin e veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë – harmonizimi;
- Bërja publike e raporteve të vlerësimit e bënë edhe më të qëndrueshëm zbatimin e PTB.

32. PËRFSHIRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN E SIGURIMIT TË TRANSPARENCËS

PTB duhet të jetë hartuar me dhe për qytetarët e komunës, andaj përfshirja e tyre që në fazën e hershme të mbledhjes së të dhënave e deri te përcaktimi i objektivave do ta kishin pasuruar programin, si dhe do ta bënë atë më të zbatueshëm. Mirëpo, këtë proces në komunën e Istogut e kanë paraprirë kufizimet në vijim të cilat e kanë caktuar edhe sigurimin e ulët të transparencës.

Së pari :

- fillimi i projektit në mes të stinës së verës;
- afati i shkurtër për hartimin e PTB;
- mungesa e sektorit të banimit për të udhëhequr procesin;
- mungesa e përvojës komunale në bërjen e analizës së pjesëmarrësve në proces për fushë të banimit;
- vonesa në marrjen e vendimit për hartimin si dhe për themelimin e GP;
- mungesa e mjeteve financiare dhe hapësinore për realizimin e takimeve, fushatës etj.

Andaj, mbetet që PTB të shpallet në publik dhe të diskutohet para miratimit të tij në Asamble komunale, bazuar në UA, nr.23/2010, "Për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit".

33. TRANSPARENCA NË HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE

Për të dëshmuar transparencë në zbatimin e PTB, komuna e Istogut do të bëjë shpallje publike e cila përmban:

- Të dhënat për përbërjen e programeve;
- Të dhënat për kategoritë e kërkesve me prioritet;
- Numrin e banesave që janë në dispozicion për programet e veçanta të banimit;
- Vendin e marrjes dhe dorëzimit të kërkesës në formë standarde;
- Dokumentacionin e nevojshëm që duhet t'i bashkëngjitet kërkesës sipas shtojcës 2 të UA;
- Afatin e paraqitjes së kërkesës;
- Afatin e shqyrtimit të kërkesës;
- Kohëzgjatjen e përfitimit nga programet trevjeçare të banimit;
- Datën e shpalljes së listës së familjeve të përzgjedhura;
- Të drejtat për ankesë.

34. ÇËSHTJE TJERA

Gjatë hartimit të programeve trevjeçare janë marrë parasysh këto standarde:

- Realizueshmëria
- Qëndrueshmëria
- Efektiviteti
- Mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe materiale
- Respektimi i ligjit
- Barazia
- Ndikimi në mjedis dhe energjia e pastër
- Normat e banimit
- Ndërthurja e këtyre programeve me politikat qendrore të banimit
- Transparenca
- Standarde të tjera

35. PËRFUNDIMET

Nevoja për hartimin dhe zbatimin efektiv të planeve për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm formimi i sektorit për banim si organi përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij plani. Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë, donatorëve dhe partneriteti publik - privat, që do të sigurojë banimin për grupe të caktuara.

Përmirësimi i kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdoshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga:

- Përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit me qira jo profitabile ose në bonus të banimit për banesat e tregut me qira të ulët;
- Stimulimi i ofertës dhe kërkesës;
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Rritja e ofertës së banesave jo profitabile, zvogëlimin - kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojnë aktivitetet ndërtimore të banimit;
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i fondit banesor.

Analizat SWOT

Anët e forta ose arritjet	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
- Infrastruktura ligjore nga fusha e banimit; - Ekzistimi i dokumenteve (planet rregulluese urbane); - Paraqitja e nevojës për zona të reja të banimit; - Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë; - Burimet njerëzore; - Infrastruktura në zonat urbane; - Ekzistimi i objekteve të kësaj natyre edhe më parë; - Nevojat ekzistuese të qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe; - Ndihmat e përfituara nga donatorët; - Përvoja të mira të mëparshme në fushën e banimit.	- Oferta dhe kërkesa jo të harmonizuara; - Kosto e lartë e pajisjes me infrastrukturë adekuate; - Kapacitetet jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social; - Mungesa e interesimit të grupeve të tjera për pjesëmarrje në këtë sidomos e të rinjve; - Mungesa e analizave adekuate që përfshinë të gjithë indikatorët të cilët mundësojnë ndërtimin kualitativ të banimit; - Mungesa e burimeve të mjaftueshme materiale dhe financiare; - Mungesa e kuadrit të specializuar në këtë lëmi; - Infrastrukturë jo e kompletuar.	- Ekzistimi i ligjeve dhe programeve shtetërore për banim; - Strategjitë komunale dhe të nivelit qendror; - Formimi i agjencisë apo sektorit për banim; - Skemat e granteve; - Programet në nivel komunal; - Shfrytëzimi më i mirë i burimeve njerëzore; - Programet nga ana e nivelit qendror për mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit dhe banimit; - Ligjet përkatëse që inkurajojnë zhvillimin e banimit (ligji PPP); - Mbështetje për ndërtimet në pronësi private si dhe shkurtimi i procedurave burokratike; - Programet mbështetëse nga partnerët nacionalë dhe ndërkombëtarë në fushën e banimit.	- Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare; - Mungesa e fondeve në nivel lokal; - Kontrolli jo i mjaftueshëm në fushën e ndërtimeve; - Trendi i rritjes së numrit të popullsisë në zonat urbane në raport me planet financiare dhe materiale në fushën e ndërtimit; - Papunësia dhe mungesa e punësimit; - Niveli i lartë i varfërisë; - Fenomeni i largimit apo e ashtuquajtura “ikje e trurit”;

PROGRAMI TREVJEÇAR I BANIMIT

Synimi i ndërtimit të banesave

Nr. i programit	Synimi i ndërtimit të banesave								
	Objektivat	Veprimet	Prioritetet: i lartë, i mesëm i ulët	Treguesit e suksesit	Mjetet e verifikimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor	Burimet financiare
PROGRAMI I	1. Përcaktimi i parcelave për ndërtim, pronë komunale	Marrja e vendimit për formimin e komisionit për identifikimin e pronave komunale (KIPK)	I lartë	Komisioni funksional	Ligji për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 Statuti i komunës	Kuvendi komunal Drejtoria për Pronë dhe Kadastër	Kryetari i komunës	5 ditë	S'ka kosto
		Identifikimi i parcelave në pronësi komunale	I lartë	Lista e parcelave në pronësi komunale	Ligji për Vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040 Statuti i Komunës	Komuna e Istogut Drejtoria për pronë dhe kadastër	Drejtori	10 ditë	S'ka kosto
		Vendim për ndarjen e parcelës për ndërtim	I lartë	Vendimi i Asamblesë komunale	Ligji për Vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040 Statuti i komunës PZHK-HZ	Kuvendi komunal Kryetari i komunës	Kuvendi komunal	1 muaj	S'ka kosto
	2. Ndërtimi i objektit banesor për dhënie me qira jo profitabile	Marrja e vendimit për ndërtimin e objektit P+4 deri P+6	I lartë	Kuvendi Komunal	Ligji për Vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040 Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit PZHK/-HZ	Kryetari i Komunës DPUM	Menaxheri i projektit Organi mbikëqyrës	45 ditë	S'ka kosto
		Hartimi i kushteve ndërtimore, kushtet tekniko – urbanistike dhe detyra projektuese	I lartë	Ligji i ndërtimit PZHK dhe HZ si dhe plani detal	Kushtet ndërtimore të hartuara, si dhe programi me numrin, madhësinë dhe llojin e njësive banesore në ndërtesë U.A. nr.24/2010 për normat të banimit për banesat nga	Drejtoria e urbanizmit për planifikim urban dhe mjedis	MMPHI/DPHNB	15 - 30 ditë	S'ka kosto

3. Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve në përputhje më UA, nr. 18/2010 të Ligjit nr. 03/L-164					programet e veçanta të banimit				
	Shpallja e tenderit për hartimin e projektit të ndërtimit	I lartë	Lista e ofertuesve	Ligji i prokurimit	Zyra e prokurimit	Kryetari i komunës	1 muaj	S'ka kosto	
	Përzgjedhja e projektit për zbatim	I lartë	Projekti për zbatim	Ligji i prokurimit Ligji i ndërtimit nr. 04/L - 110	Zyra e prokurimit Komisioni vlerësues	KRPP OSHP	10 ditë	S'ka kosto	
	Nënshkrimi i kontratës mes AK-së dhe OE-së.	I lartë	Kontrata	Ligji i prokurimit Ligji i ndërtimit nr. 04/L - 110	Kryetari i komunës Zyra e prokurimit	KRRPP OSHP	1 ditë	S'ka kosto	
	Shpallja e tenderit për ndërtim Përzgjedhja e OE-së për zbatim të projektit Nënshkrimi i kontratës midis AK-së dhe OE-së	I lartë	Lista e Operatorëve Ekonomik Kontrata	Ligji i prokurimit Ligji i ndërtimit nr. 04/L - 110	Kryetari i komunës Zyra e prokurimit	KRRPP OSHP	1 muaj	S'ka kosto	
	Formimi i komisionit për vlerësim nga 3 deri 5 anëtarë	I lartë	Komisioni funksional	Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit PZHK/ HZ Vendimi i komunës së Istogut	Kryetari i komunës	MMPHI/ DPHNB	10 ditë	S'ka kosto	

		Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve me qëllim të vazhdimit ose ndërprerjes së kontratës	I lartë	Lista e familjeve të rivlerësuara	UA nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë UA nr. 18/2010 të Ligjit nr. 03/L - 164	Komisioni	Kryetari i komunës	1 muaj	S'ka kosto
		Përpilimi i listës përfituese	I lartë.	Lista e përfituesve	Ligji nr. 03/L - 164	Komisioni	Kuvendi komunal	10 ditë	S'ka kosto
		Largimi i familjeve të cilat nuk i plotësojnë kriteret	I lartë	Vendimi për largim	Ligji nr. 03/L - 16.	Inspektori	Policia e Kosovës	1 muaj	S'ka kosto
		Përzgjedhja e familjeve të reja përfituese	I lartë	Lista e përfituesve	Ligji nr. 03/L - 164	Komisioni	Kryetari i komunës	1 muaj	S'ka kosto
		Nënshkrimi i kontratave	I lartë	Kontrata të nënshkruara	UA nr. 18/2010 të ligjit nr. 03/L - 164	Kryetari dhe përfituesit/ et	Kryetari i komunës	Shkurter	S'ka kosto
PROGRAMI II	01. Marrja me qira me bonus e banesave/ shtëpive private	Caktimi i vlerës së bonusit të banimit për vitin aktual	I lartë	Vendimi	Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit UA nr. 19/2010 mbi përmbajtjen e bonusit të banimit	Kuvendi komunal	MMPHI	1 vjeçar	50% e vlerës së qirasë minimale
		Formimi i komisionit për identifikimin e banesave	I lartë	Vendimi	Ligjit nr.03/L-164	Kryetari i komunës DPUM	Kryetari i komunës DPUM	5 ditë	S'ka kosto
		Kontakti me pronaret e banesave/ shtëpive	I lartë	Lista e pronarëve	Ligjit nr.03/L-164	Komisioni	Kryetar i komunës	15 ditë	S'ka kosto

		Hartimi i listës së banesave/ shtëpive të mundshme për dhënie me qira	I lartë	Lista e banesave	Ligjit nr.03/L-164.	Komisioni	Kryetar i komunës	10 ditë	S'ka kosto
		Hartimi i marrëveshjes me pronarët për shfrytëzimin e banesave me qira me bonus	I lartë	Kontrata mes palëve	ligji nr.03/L-164 udhëzim Adm. nr.19/2 010 mbi përmbajtjen e bonusit të banimit	Zyra ligjore	Zyra ligjore	2-5 ditë	S'ka kosto
	02. Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi	Zgjedhja e Administratorit	I lartë	Kontrata për administrim	Ligji nr. 04/L - 134 Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi	Pronarët e banesave	DI	3-5 ditë	S'ka kosto
		Hartimi i projektit për menaxhim	I lartë	Programi i menaxhimit	Ligji nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi	Bashkësia e pronarëve	DI.	30 ditë	500 €
		Nënshkrimi i kontratës për administrim	I lartë	Marrëveshja mes palëve	Ligji nr. 04/L-134, Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi	Bashkësia e pronarëve	Komuna DI- DPUM	2-5 ditë	S'ka kosto